

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6106  
E shtunë, 5 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

## Edhe tre të vdekur dhe 119 raste të reja me Covid-19

1 FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### KOSOVA DHE SERBIA HAPIN NJË FAQE TË RE TË BASHKËPUNIMIT

# NË AMERIKË NËNSHKRUHET MARRËVESHJA EKONOMIKE



Në prani të presidentit amerikan Donlad Trump, Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshjen historike. Në marrëveshje

parashihet që Kosova dhe Serbia janë pajtuar për normalizimin e raporteve ekonomike. Po në të parashihet që Kosova dhe

Serbia të përfshihen në të ashtuquajturën Zonën Mini-Shengen. Gjithashtu, palët janë pajtuar që Kosova për një vit t'i shtyjë

kërkesat për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, ndërsa Serbia për një vit ta pezullojë fushatën dhe lobimin kundër njohjes së

shtetit të Kosovës. Ashtu siç është paraparë në marrëveshje, Izraeli e ka njohur Republikën e Kosovës shtet

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SPORT**  
KOSOVA 'HARRON' DËSHTIMIN  
NDAJ MOLDAVISË, PËRGATITET  
PËR NDESHJEN ME GREQINË F. 20

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelanda e Re regjistron vdekjen e parë nga Covid-19 pas më tepër se tre muajsh

WELLINGTON, 4 SHTATOR - Zelanda e Re ka njoftuar për vdekjen e saj të parë nga Covid-19 në më shumë se tre muaj të premtën, sipas ministrisë së saj të Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë në këtë shtet ka raportuar se burri

në të 50-at e tij ishte i lidhur me infeksionet e gushtit në Auckland.

Vdekja e fundit e Zelandës së Re nga virusi ishte më 28 maj. Numri i të vdekurve nga Covid-19 i vendit tani është 23. "Me një zemër shumë të rëndë

ne e pranojmë që Covid-19 i ka marrë jetën dikujt në komunitetin tonë. Mendimet tona janë me familjen e këtij personi dhe të tjerët", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Zelandës së Re në rrjetin social në "Twitter".



## Punëtorët shëndetësorë po vdesin nga Covid-19 në shkallë tronditëse

LONDËR, 4 SHTATOR - Organizata Amnesty International thotë se në të gjithë botën, të paktën 7 000 punonjës shëndetësorë kanë vdekur nga koronavirusi i ri.

Organizata thotë se ata që luftojnë me pandeminë në vijat e para të frontit kanë nevojë për qasje të duhur në pajisjet mbrojtëse. "Çdo punonjës shëndetësor ka të drejtën të jetë i sigurt në punë dhe është një skandal që kaq shumë po paguajnë këtë çmim", tha Steve Cockburn, shef për drejtësi ekonomike dhe sociale në grupin e të drejtave me bazë në Londër. "Shumë muaj në pandemi, punëtorët shëndetësorë ende po vdesin me ritme të tmerrshme në vende të tilla si Meksika, Brazili dhe ShBA-ja, ndërsa përhapja e shpejtë e infeksioneve në Afrikën e Jugut



dhe Indi tregon nevojën që të gjitha shtetet të ndërmarrin veprime", tha ai. Të paktën 1 320 punonjës

shëndetësorë kanë vdekur nga koronavirusi në Meksikë më shumë se në çdo vend tjetër në botë.

Amnesty International gjithashtu regjistroi numër të lartë vdekjesh midis punonjësve shëndetësorë në

vendet e tjera, përfshirë Shtetet e Bashkuara me 1 077 vdekje; Mbretëria e Bashkuar me 649; Brazili me 634; Rusia me 631; India me 573; Afrika e Jugut me 240; dhe Irani me 164.

Shtetet e Bashkuara, Brazili dhe India kanë regjistruar numrin më të lartë të vdekjeve të përgjithshme dhe rasteve të të infektuarve me koronavirus. "Më shumë se shtatë mijë njerëz të vdesin derisa përpiqen të shpëtojnë të tjerët, kjo është një krizë në një shkallë tronditëse", tha Cockburn.

Organizata e të drejtave të njeriut tha se duhet të ketë bashkëpunim global për të siguruar që të gjithë punonjësit shëndetësorë, duke përfshirë pastruesit në objektet shëndetësore, të kenë pajisje të përshtatshme mbrojtëse.

## Kryeministri grek i kërkon Turqisë t'i ndalë kërcënimet nëse dëshiron dialog



ATHINË, 4 SHTATOR - Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis tha të premtën se Turqia duhet t'i ndalë "kërcënimet". Deklarata e tij bëhet pas paralajmërimeve nga NATO-ja se të dyja vendet janë pajtuar për ta nisur dialogun për uljen e tensionit në Mesdheun lindor. "Kërcënimet duhet të shuhet në mënyrë që kontaktet të fillojnë", tha Mitsotakis. Ai tha se ministri i Jashtëm grek, Nikos Dendias, do të informojë po të premtën vonë sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres,

mbi "veprimtarinë e paligjshme" të Turqisë. Greqia mohoi të enjten vonë se kishte rënë dakord të zhvillonte bisedime me Turqinë, të ndërmjetësuara nga NATO-ja, për t'i ulur tensionet mbi kufijtë detarë dhe të drejtat e kërkimit të gazit dhe naftës në rajon. "Informacioni i botuar që pretendon se Greqia dhe Turqia kanë rënë dakord t'i mbajnë të ashtuquajturat 'bisedime teknike' mbi uljen e tensioneve në Mesdheun lindor nuk kanë të bëjnë me realitetin", ka njoftuar Ministria e Jashtëm e

Greqisë. Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, më herët kishte thënë se të dy aleatët e NATO-s kishin "rënë dakord të fillojnë bisedime teknike në NATO për të krijuar mekanizma që do ta zvogëlonin rrezikun e incidenteve në Mesdheun Lindor".

Tensionet mes dy vendeve janë rritur pasi Turqia më 10 gusht dërgoi anije kërkimore dhe ushtarake në Mesdhe.

Greqia dhe Qipro thonë se ky veprim ka shkelur sovranitetin e tyre.

## Veliaj: Kemi përveshur mëngët për një fitore tjetër të Partisë Socialiste

TIRANË, 4 SHTATOR - Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka deklaruar se Partia Socialiste në krye të agjendës së saj ka rindërtimin dhe çështjet të cilat lidhen drejtpërdrejt me mirëqenien e qytetarëve. Duke folur në një

intervistë të dhënë për "Report TV" mbi takimin e zhvilluar një ditë më parë nga kryeministri Edi Rama me kryebashkiakët socialistë, ku kreu i Bashkisë së Tiranës është edhe drejtues politik i këtij qarku, Veliaj tha se orien-

timi kryesor politik është drejt punëve publike. "Partia Socialiste është një parti jo vetëm më e madhja, më patriotikja dhe, ndoshta, më jetëgjatë në menaxhimin e punëve të vendit, por është edhe një nga partitë më të disiplinuar.

Ne nuk besojmë që fushata është bixhoz. Ne nuk besojmë që rrëmuja, ulërima, sharjet që karakterizojnë tipikisht fushatat në Shqipëri, janë zgjidhja. Kemi përveshur mëngët për një fitore tjetër të Partisë Socialiste", ka thënë ai.



Policia e Kosovës ka shënuar të premten 21-vjetorin e themelimit

# Policia 21 vjet, shembull për punë, integritet dhe profesionalizëm



**Liderët politikë falënderojnë policinë për angazhimin e tyre**

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e 21-vjetorit të themelimit, është shprehur mirënjohës ndaj tyre për punën dhe angazhimin në këto 21 vjet. “Faleminderit afër 10 mijë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, të uniformuar dhe civilë, për punën dhe angazhimin e tyre në këto 21 vjet”, ka shkruar Thaçi në profilin e vet në “Facebook”. Për këtë përvjetor policinë e ka uruar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. “U bën njëzet e një vjet prej kur Kosova u bë me polici të vet. Mijëra vajza e djem të uniformuar përgjatë më shumë se dy dekada ofrojnë siguri për qytetarët. Policia e Kosovës është institucioni më i besueshëm dhe më profesional në vendin tonë, institucion ky që konsiderohet model edhe për vendet e rajonit. Mirënjohës përjetë gjithë pjesëtarëve të PK-së që ranë në krye të detyrës. Ata janë heronjtë tanë të paqes. Kujtimi dhe nderimi për ta do të jetë gjithmonë pjesë e rrugëtimit tonë si shtet e si popull”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

siguruar atë dhe banorët e saj është edhe vlerësim maksimal që shteti ta ka besuar”, ka deklaruar Qala. Sipas tij, pjesëtarët e Policisë së Kosovës për gjithë këto vite kanë qenë pasqyrë e shtetit të Kosovës në të gjitha pikëkalimet kufitare dhe në secilën pjesë tjetër të vendit duke punuar 24 orë 7 ditë në javë.

Policia e Kosovës është një nga institucionet që ka renditur Kosovën si një histori suksesi në arenën ndërkombëtare. Kështu është thënë në 21-vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës. Përfaqësuesit e institucioneve të shtetit kanë bërë me dije se Policia e Kosovës tashmë është ngritur në një institucion modern që është shembull për punë, përkushtim, integritet dhe profesionalizëm. 21-vjetori e gjen këtë institucion me njëzet e një “heronj të Kosovës” të rënë në krye të detyrës

**EPOKA ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Policia e Kosovës (PK) ka shënuar 21-vjetorin e themelimit të saj, e cila më 6 shtator 1999 është themeluar si një ndër institucionet e para në Kosovë. Në ceremoninë e organizuar sipas standardeve të parapara, duke iu përshtatur situatës aktuale nga pandemia, është vlerësuar lart kontributi i këtij institucioni në shërbim të forcimit të rendit. Me këtë rast, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka vlerësuar kontributin e gjeneratave që barten mbi supe përgjegjësi të madhe. “Policia e Kosovës mbas 21 vjetëve u ngrit në një institucion modern që është shembull për punë, përkushtim, integritet dhe profesionalizëm jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Gjatë

kësaj periudhe Policia e Kosovës u godit shumë herë nga ata që për interes kanë destabilizimin, kaosin dhe përfitimet nga aktivitetet kriminale, prandaj sot kujtojmë 21 zyrtarë të saj të rënë në krye të detyrës, pishtarë të rendit dhe sigurisë”, ka thënë Veliu.

Ai ka shtuar se tani është koha të shkojmë një hap përpara.

“Të promovojmë një vizion të ri, e që është një polici moderne, kredibile e ndërtuar mbi parimet e policimit demokratik, por edhe partner i besueshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtare. Republika e Kosovës nuk është më vetëm konsumuese e sigurisë, por edhe faktore

stabiliteti dhe kontribuuese në iniciativat rajonale të sigurisë”, ka deklaruar ministri Veliu. Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se ky institucion është një nga institucionet e para të themeluara në Kosovën e pas luftës. “Që nga themelimi e deri në ditët e sotme Policia e Kosovës është një nga institucionet që ka renditur vendin tonë si një histori suksesi në arenën ndërkombëtare si vend i ri dhe në zhvillim. Policia e Kosovës kishte dhe ka përgjegjësi shumë të madhe për funksionimin e mekanizmave të tjerë në vend, pasi që detyra e saj është siguria e jetës dhe pronës së qytetarëve të Kosovës. Ta sigurosh jetën dhe pronën e qytetarit është detyrë shumë e rëndësishme dhe me shumë përgjegjësi, por të jesh në shërbim të vendit duke

## 21-vjetori e gjen policinë me 21 ‘heronj të Kosovës’

Përveç përfaqësuesit e institucioneve, në ceremoni të pranishëm ishin edhe familjarët e zyrtarëve policorë të rënë në kryerje të detyrës, të cilët me rastin e 21-vjetorit të Policisë së Kosovës, presidenti i Republikës së Kosovës i ka dekoruar me urdhrin “Hero i

Kosovës”. Në radhët e Policisë së Kosovës janë 21 zyrtarë policorë të cilët kanë rënë në kryerje të detyrës, duke mos kursyer as jetën për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike dhe për parandalim të krimit, të cilët janë dekoruar me urdhrin “Hero i Kosovës”.

## Veliu pret në takim ambasadorin e Turqisë, flasin për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar, me të cilin

kanë biseduar për situatën e përgjithshme në vend, për menaxhimin me pandeminë Covid-19 dhe për angazhimet e MPB-së në për zbatimin e masave të Qeverisë së Kosovës.

Në këtë takim, po ashtu, u bisedua për rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve në projekte të ndryshme dhe për gjetjen e formave dhe mundësive për ngritjen e kapaciteteve.



KOSOVA DHE SERBIA HAPIN NJË FAQE TË RE TË BASHKËPUNIMIT

# NË AMERIKË NËNSHKRUHET



Në prani të presidentit amerikan Donlad Trump, Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshjen historike. Në marrëveshje parashihet që Kosova dhe Serbia janë pajtuar për normalizimin e raporteve ekonomike. Po në të parashihet që Kosova dhe Serbia të përfshihen në të ashtuquajturën Zonën Mini-Shengen. Gjithashtu, palët janë pajtuar që Kosova për një vit t'i shtyjë kërkesat për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, ndërsa Serbia për një vit ta pezullojë fushatën dhe lobimin kundër njohjes së shtetit të Kosovës. Ashtu siç është paraparë në marrëveshje, Izraeli e ka njohur Republikën e Kosovës shtet

ofruara në dispozicion nga MCC, nga DFC, nga Banka Eksport-Import e ShBA-së dhe ka zotim të qartë të presidentit Trump që të gjitha këto projekte të fillojnë së zbatuari brenda një viti. Ky është zotimi që kemi marrë nga administrata e Trumpit", ka deklaruar Hoti.

## Pikat kryesore të marrëveshjes

Në paragrafin e parë të marrëveshjes thuhet se Serbia dhe Kosova kanë pranuar t'i normalizojnë marrëdhëniet e tyre ekonomike. Sipas kësaj marrëveshje, Kosova dhe Serbia do të përfshihen në të ashtuquajturën Zonën Mini-Shengen. "Të dyja palët do t'i bashkohen 'zonës së mini-Shengenit', të shpallur nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, në nëntorin e vitit 2019, dhe do t'i shfrytëzojnë plotësisht përfitimet prej saj", thuhet në marrëveshje. Një pikë tjetër e këtij dokumenti thekson se Kosova është pajtuar që për një vit t'i shtyjë kërkesat për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, ndërsa Serbia për një vit ta pezullojë fushatën dhe lobimin kundër njohjes së shtetit të Kosovës. Gjithashtu, marrëveshja flet edhe për liqenin e Ujmanit. "Të dyja palët do të bien dakord të punojnë me Departamentin e Energjisë së ShBA-së dhe institucionet përkatëse të Qeverisë së ShBA-së në një studim të fizibilitetit për qëllimet e ndarjes së Liqenit

Gazivodë/Ujmani, si një furnizim i mundshëm i ujit dhe energjisë", thuhet në njërin nga pikat e marrëveshjes. Ndërsa pika e fundit tregon se Kosova dhe Izraeli janë pajtuar që ta njohin njëra-tjetrën.

## Kosova dhe Izraeli vendosin marrëdhënie diplomatike

Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes, Izraeli e ka njohur Republikën e Kosovës. Kurse kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka folur për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën. "Kosova ka rënë dakord ta hapë ambasadën në Izrael, konkretisht në Jerusalem", ka deklaruar ai. Sipas tij, Kosova është bërë vendi i parë me shumicë myslimane që do ta ketë ambasadën në këtë vend. Duke folur në Shtëpinë e Bardhë, presidenti amerikan Trump ka thënë se Serbia ka shprehur përkushtimin ta zhvendosë ambasadën e vet nga Tel Avivi në Jerusalem. Edhe kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, e ka konfirmuar këtë lajm. Pas SHBA-së, Serbia bëhet vendi i parë evropian që e bën një veprim të tillë, tha të premtën kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu. "Falënderoj mikun tim, presidentin e Serbisë, për vendimin për ta njohur Jerusalem kryeqytet të Izraelit dhe për ta transferuar ambasadën atje", ka deklaruar Netanyahu.

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 4 shtator** - Republika e Kosovës dhe Serbia kanë nënshkruar të premtën marrëveshjen për normalizim ekonomik në Shtëpinë e Bardhë. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, marrëveshjen e kanë nënshkruar në prani të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, në Zyrën Ovale. Pas ceremonisë së nënshkrimit, presidenti Trump këtë marrëveshje e ka vlerësuar historike. "Pas një historie të dhunshme dhe tragjike dhe vitesh negociatash të dështuara, administrata ime propozoi një mënyrë të re për ta kapërcyer ndarjen", ka deklaruar ai, duke shtuar se Kosova dhe Serbia kanë shprehur përkushtimin e tyre që t'i normalizojnë raportet ekonomike. "Duke u përqendruar në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike, të dy vendet ishin

në gjendje të arrijnë një përparim të vërtetë për bashkëpunimin ekonomik për një gamë të gjerë çështjesh", ka deklaruar Trump. Ai ka thënë se kjo është një ditë shumë e rëndësishme, duke shtuar se pas historisë së dhunës dhe negociatave të dështuara, administrata e tij ka bërë një "përparim të madh" në dialog dhe se "askush nuk ka menduar se kjo do të ishte e mundur". Trumpi ka deklaruar se shpreson se "do të shkojë në të dyja vendet në një të ardhme jo aq të largët" dhe se ai është "krenar për dy udhëheqësit". Kurse këshilltari për Siguri Kombëtare i presidentit Trump, Robert O'Brien, ka thënë se derisa marrëdhëniet ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë kultivohen, do të ketë edhe zgjidhje politike. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka deklaruar se marrëveshja me Serbinë është një hap i madh përpara që do të çojë në njohjes reciproke mes dy vendeve. Ai ka deklaruar se bisedimet për marrëveshjen

finale do të vazhdojnë në Bruksel. "Kjo marrëveshje e sotme është një hap i madh drejt njohjes reciproke. Kjo nënkupton një arritje të madhe drejt finalizimit të marrëveshjes me Serbinë. Bisedimet do të vazhdojnë për të diskutuar për arritjen finale", ka thënë Hoti gjatë ceremonisë. Më pas, në një konferencë për media kryeministri Hoti ka treguar për investimet që do të ndodhin sipas kësaj marrëveshje. "Projekte të mëdha infrastrukturore që përfshijnë autostradën Prishtinë - Merdar, që përfshinë studimin e fizibilitetit për hekurudhën me detin Adriatik dhe mbështetje të madhe financiare për ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Po ashtu, investime në energjetikë përmes sjelljes të gazit në Prishtinë dhe ndërtimin e termocentralit me gaz dhe shpërndarjen e tij në Kosovë. Të gjitha këto marrëveshje kapin shumën mbi një miliard euro, financa të

# MARRËVESHJA EKONOMIKE

## Marrëveshja është mirëpritur në Kosovë

I pari që e ka përshëndetur marrëveshjen e arritur ka qenë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka falënderuar ShBA-në dhe presidentin Trump. "Zhvillimi ekonomik, krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e mirëqenies sociale për qytetarët, projektet infrastrukturore me kapital të madh, linjat ajrore, hekurudhore dhe autostradat kanë qenë gjithmonë prioritetet e shtetit të Kosovës, njësoj sikur edhe nevoja për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur dhe kthimi individual i të gjithë të zhvendosurve në shtëpitë dhe pronat e tyre. Këto angazhime kanë pasur ndikime pozitive në tërë Ballkanin Perëndimor", ka shkruar Thaçi, duke përkrahur lidhshimin e presidentit Trump. "Shpreh konsideratën më të lartë për lidhshimin e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, presidentin Trump, që sot arriti ta materializojë përpjekjen për të arritur mirëkuptim mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë për të mirën e paqes, zhvillimit ekonomik dhe të ardhmes euroatlantike. E falënderoj edhe një herë

emisarin special, ambasadorin Grenell, për angazhimin e tij gjigant që ky proces të jetë produktiv, efikas dhe besoj edhe i implementueshëm", ka shkruar Thaçi. Ai ka pohuar se Kosova beson në lidhshimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në vizionin e Uashingtonit. "Pasi gjatë gjithë historisë së Kosovës kjo i ka sjellë vetëm përfitime, si çlirim dhe pavarësimin e Kosovës, themelimin e ushtrisë që do të përfundojë me integrimin në NATO, si dhe tash edhe zhvillim ekonomik. Kosova tani duhet të vazhdojë të punojë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe për njohje të reja, që shteti ynë të konsolidohet plotësisht në rrafshin e brendshëm dhe ndërkombëtar. Miqësia mes Kosovës dhe ShBA-së është e përjetshme", ka thënë presidenti Thaçi.

Marrëveshjen e kanë përkrahur edhe udhëheqësit e koalicionit qeverisës. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se Kosova është e bekuar me miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Kjo u dëshmuar edhe një herë sot, me nënshkrimin e marrëveshjes së negociuar nën drejtimin e Shtëpisë së Bardhë. Si kryetar i LDK-së dëshiroj t'i falënderoj

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sidomos presidentin Trump, për angazhimin e tij në arritjen e marrëveshjes. Po ashtu, përgëzoj kryeministrin Hoti dhe Qeverinë e Kosovës për këtë arritje të madhe në interes të Republikës së Kosovës. Kryeministri dhe qeveria, me maturi e përkushtim, në pak javë, arritën ta ribëjnë Kosovën partnere të besueshme të aleateve tona strategjike, ShBA-së dhe BE-së, prandaj ky kryeministër dhe qeveria e tij meritojnë mbështetje në rrugëtimin që kanë nisur. Faleminderit president Trump!",

ka shkruar Mustafa. Ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili para nënshkrimit ka kundërshtuar marrëveshjen, ka thënë se janë marrë parasysht shqetësimet e tij. "Miqët e vërtetë gjithmonë e kuptojnë shqetësimin e drejtë. I lumtur që shqetësimet tona në pikën kontestuese për Ujmanin kanë reflektuar në marrëveshjen e nënshkruar. Besimi ynë në rolin dhe angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjithmonë ka qenë i paluhatshëm dhe i tillë mbetet! Faleminderit president Trump! Zoti i bekoftë Shtetet e Bashkuara

të Amerikës!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse partneri tjetër qeverisës, Nisma Socialdemokrate, pret që kjo marrëveshje t'i japë shtytje më të madhe zhvillimit ekonomik. "Marrëveshja për normalizim ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë, që parasheh investime miliardëshe në shumë fusha, është e mirëpritur për Kosovën. Investimet në infrastrukturë hekurudhore, rrugore, në rrjetin e gazsjellësit etj. do t'i japin shtytje të madhe ekonomisë së vendit tonë", është thënë në postimin e Nismës në "Facebook".

## PDK-ja: Delegacioni i Kosovës humbi shansin për marrëveshje finale që siguron njohjen e ndërsjellë dhe ulësen në OKB

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e sheh me shqetësim të madh shansin e humbur nga delegacioni i Kosovës për marrëveshje finale të njohjes së ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë që duhej të ndodhte sot në Uashington. "Çdo marrëveshje e nënshkruar në këtë mënyrë, pa transparencë, që nuk ka njohje të ndërsjellë, krijon shqetësim dhe pasiguri. Aq më tepër, deri në këtë moment, nuk është bërë publike përbajtja e

marrëveshjes. PDK-ja që nga fillimi ka qenë e bindur se përfshirja e ShBA-së në procesin e përmbylljes së dialogut në mes të Kosovës e Serbisë është e domosdoshme, por marrëveshjet që nuk parashohin njohje të ndërsjellë, nuk ofrojnë zgjidhje të problemit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për më tepër, është edhe më e rëndë në qoftë se ka cenim të Kushtetutës, sovranitetit dhe interesave strategjike të Kosovës", thuhet


në komunikatën e PDK-së. "Nuk ka negociata me territore e as me pasurinë tonë kombëtare. Qëndrimi i PDK-së ka qenë dhe mbetet, se në Uashington dhe Bruksel të shkohet për një marrëveshje gjithëpërfshirëse e përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë që garanton njohje të ndërsjellë, ulësen në OKB dhe nuk e cenon integritetin territorial të vendit", theksohet më tutje në komunikatë.



Kryetarja e Kuvendit e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim shefin e Zyrës së BE-së, njëherësh përfaqësues special, Tomas Szunyog

## Osmani: Liberalizimi duhet të ndodhë, Kosova i ka plotësuar kriteret

Kryetarja e Kuvendit e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë takimit me shefin e Zyrës së BE-së, njëherësh përfaqësues special, Tomas Szunyog, ka kërkuar që BE-ja t'i përmbushë obligimet e veta ngaqë Kosova tashmë ka plotësuar kriteret e parapara për liberalizim vizash. Në këtë kontekst, Osmani ka thënë se sundimi i ligjit është prioritet dhe se kjo do të arrihet edhe në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë



**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryetarja e Kuvendit e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në një takim shefin e Zyrës së BE-së, njëherësh përfaqësues special, Tomas Szunyog. Kryetarja Osmani e ka uruar Szunyog për marrjen e detyrës duke shfaqur besimin për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Në takim u diskutua për zhvillimet aktuale politike në vend dhe u tha se Kuvendi i Kosovës nuk duhet të anashkalohej nga Qeveria e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë ngaqë është institucioni më i lartë ligjvënës dhe mbikëqyrës në politikën e jashtme. Osmani ka shprehur gatishmërinë që ky institucion të marrë rol më të madh në procesin e integriteteve evropiane, si një ndër proceset më të rëndësishme të shtetit të Kosovës. Ajo ka kërkuar që BE-ja t'i përmbushë obligimet e

veta ngaqë Kosova tashmë ka plotësuar kriteret e parapara për liberalizim vizash. Në këtë kontekst, Osmani ka thënë se sundimi i ligjit është prioritet dhe se kjo do të arrihet edhe në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë.

Ndërkaq Szunyog ka thënë se Zyra e BE-së e rikonfirmon rekomandimin e Komisionit Evropian të vitit 2018, sipas të cilit, Kosova i ka plotësuar kriteret për liberalizim, porse vendimi mbetet në kompetencë të shteteve anëtare të kështillit të ministrave të BE-së. Ai, gjithashtu, tha se Kosova duhet të përkushtohet për përmbushjen e kërkesave që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, duke potencuar se BE-ja do të mbetet edhe më tej partner i Kosovës në rrugëtimin e saj. Kryetarja Osmani ka falënderuar BE-në për ndihmën që i ka dhënë Kosovës në menaxhimin e pandemisë dhe ka kërkuar mbështetje të mëtejshme.

## Thaçi i ofron bashkëpunim shefit të ri të Zyrës së BE-së në Kosovë

Edhe presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të premten në takim njoftues shefin e ri të Zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadorin Tomas Szunyog, të cilit i ka dëshiruar mirëseardhje në Kosovë dhe suksese në punën e re.

Presidenti Thaçi u shpreh se Kosova ka vetëm një drejtim,

anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duke theksuar vullnetin e institucioneve që të punojnë pa ndal në këtë drejtim. "Është arritur shumë, por edhe shumë mbetet për t'u bërë", ka thënë presidenti Thaçi.

Ambasadori Szunyog u shpreh i lumtur me detyrën e re dhe njoftoi për projektet e reja të BE-

së, veçanërisht ato me theks për tejkalimin e krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia e virusit Covid-19. Presidenti Thaçi e siguroi ambasadorin Szunyog se do ta ketë përkrahjen dhe bashkëpunimin e plotë të institucioneve të shtetit të Kosovës për realizimin e projekteve që afrojnë Kosovën drejt BE-së.

## Haradinaj: Adrian Krasniqi ishte shembulli tipik i shqiptarit

PEJË, 4 SHTATOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në zbulimin e pllakës në shtëpinë e babait të heroit të kombit Adrian Krasniqi. "Adrian Krasniqi ishte shembulli tipik i shqiptarit. Student e luftëtar. I dashur e i guximshëm. Hero e gjeneral. Sot në Pejë zbuluam pllakën në shtëpinë e babait të tij Rexhepit, shtëpi që Adriani e kishte shndërruar në bazë për veprimet në dobi të rezistencës për liri", kështu



ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Lideri i AAK-së, xhaxhait të Adrianit, Xhafer Krasniqi, i ka

ndarë medaljen "Me besim në Zot, Atdhe e Shtet" në nderim të kontributit të tij për çështjen kombëtare.



## Turqia vazhdon donacionet për FSK-në

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Në kazermën "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë të premten është bërë pranim-dorëzimi i kontingjentit të dytë të donacionit me veshmbathje ushtarake nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës në vlerë financiare prej një milion dollarësh. Ceremonia e pranim-

dorëzimit të pajisjeve përkatëse u bë në prani të zyrtarëve dhe oficerëve të logjistikës së Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së dhe Komandës së Logjistikës si dhe atasheut ushtarak turk në Kosovë me stafin e tij. Në emër të qeverisë turke, donacionin e dorëzoi atasheu i

Republikës së Turqisë, kolonel Ismail Cenkeri Ersoz, kurse në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, e pranoi oficeri i Departamentit i Logjistikës i ShPFSK-së, major Nazmi Zogaj, i cili falënderoi kolonel Ersoz për donacionin e dhuruar dhe mbështetjen e vazhdueshme të ushtrisë dhe shtetit turk për FSK-në.



# Edhe tre të vdekur dhe 119 raste të reja me Covid-19



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka konfirmuar të premten edhe 119 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja rezultuan nga testimi i 474 mostrave. IKShPK-ja ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë raportuar edhe tri raste të vdekjes me Covid-19 dhe 187 pacientë të shëruar

komuna Ferizaj 4 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Hani i Elezit 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Istog, Kamenicë, Klinë, Lipjan dhe Shtime.

## Zemaj merr zotimin e donatorëve ndërkombëtarë për vazhdimin e përkrahjes për shëndetësinë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se ka marrë zotimin e donatorëve ndërkombëtarë për vazhdimin e përkrahjes me

donacione për Ministrinë e Shëndetësisë dhe shëndetësinë e Kosovës. "Në takimin virtual që zhvilluam sot u vlerësua lart menaxhimi i situatës epidemiologjike si dhe biseduam për donacionet, ndihmën dhe financimin e projekteve të ardhshme të shëndetësisë sonë, të bazuara në nevojat, kërkesat dhe dokumentet strategjike të MSh-së dhe të Qeverisë së Kosovës. Përfaqësuesit e donatorëve dhe ambasadorët i njoftova hollësisht për punën që po bëhet në shëndetësi, për dinamikën e angazhimeve për t'i jetësuar projektet e caktuara, për sigurimet shëndetësore për qytetarët, për hartimin dhe plotësimin e projektligjeve përkatëse", ka thënë Zemaj.

Ai ka shtuar se deri më tani për nevojat e institucioneve shëndetësore të Kosovës janë

ofruar donacione ndërkombëtare me pajisje personale mbrojtëse, kite për testim RT PCR, aparatura, ventilatorë, monitorë për pacientë, autoambulanca, shtretër, koncentratorë të oksigjenit, medikamente si dhe gjëra të tjera të rëndësishme të veçantë. "Aktualisht përmes projekteve janë të angazhuar donatorë nga shtete të ndryshme si: SHBA-ja, Japonia, Luksemburgu, Gjermania, Austria, Zvicra, Norvegjia, Turqia, Jordania, Katari, Zyra e Bashkimit Evropian, Agjencinë e Kombeve të Bashkuara (OBSh, UNICEF, UNDP, Banka Botërore). I falënderova ambasadorët dhe donatorët për kontributin dhe përkrahjen e vazhdueshme për shëndetësinë tonë, e cila është thelbësore në këtë kohë të vështirë", ka deklaruar ministri Zemaj.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 474 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 119 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar edhe tri raste të vdekjes me Covid-19.

Numri total i rasteve pozitive është 13 910 raste nga 53 090 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 551 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 187 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 300 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 059.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 35 raste, komuna Gjakovë 10 raste, komuna Gjilan 8 raste, komuna Pejë 7 raste, komuna Podujevë 7 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Vushtrri 6 raste,

## Kërkohet që të rritet efektiviteti i organeve gjyqësore në kohë pandemie



PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në një takim shefin e misionit të EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark. Në takim është biseduar për situatën aktuale me pandeminë Covid-19 dhe menaxhimin e saj. Wigemark ka përgëzuar kryetaren Osmani për miratimin ne

Kuvend të Ligjit për Pandeminë, me të cilin sigurohet baza ligjore për menaxhim më efikas të kësaj situatë.

Shefi i EULEX-it ka shprehur shqetësimin për dinamikën e ulët të proceseve gjyqësore gjatë kohës së pandemisë. Kryetarja Osmani potencoi se mbrojtja e të drejtave të palëve në procese gjyqësore dhe

evitimi i vonesave është me rëndësi në kohë pandemie. Në këtë kontekst është përmendur edhe çështja e zgjedhjes së avokatit të popullit. Të dyja palët u pajtuan që ky proces duhet të shoqërohet me respektim të bazës ligjore, në mënyrë që në krye të këtij institucioni të vihet person i përgatitur profesionalisht dhe me integritet.

## Tatimet në produkte mbushin buxhetin e shtetit me 47 për qind



Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shuma e të hyrave të qeverisë së përgjithshme në tremujorin e dytë (TM2) 2020 ishte 587.2 milionë euro, kurse pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte që paraqesin 47.4 për qind të totalit të të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar raportin për llogaritë qeveritare të Kosovës në bazë tremujore. Sipas ASK-së, ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe (TM2 2020). "Shuma e të hyrave të qeverisë së

përgjithshme në TM2 2020 ishte 587.2 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, që paraqesin 47.4 për qind të totalit të të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, shuma e shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme në TM2 2020 ishte 534.9 milionë euro.

"Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: kontributet sociale dhe përfitimet (35.1 për qind); kompensimi i punëtorëve (32.2 për qind); formimi i kapitalit bruto (11.1 për qind); dhe konsumi i ndërmjetëm (8.8 për qind). Ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategori të tjera të shpenzimeve", është thënë në raportin e ASK-së.


## Shënon rënie indeksi i çmimeve të prodhimit

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për tremujorin e dytë (TM2) 2020. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë pësoi rënie për (-1.2 për qind) ndërmjet TM1 2020 dhe TM2 2020. Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-28.5 për qind); prodhimi i metaleve (-2.6 për qind); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-1.8 për qind); prodhimi i pijeve (-1.3 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (-0.8 për qind); prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0.7 për qind); dhe prodhimi i produkteve minerale jometalike (-0.2 për qind).

Në raport theksohet se rënia u neutralizua me ngritjen e çmimeve te: prodhimi i mjeteve motorike të

(transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove (6.0 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse (3.3 për qind); prodhimi i produkteve kimike (1.1 për qind); prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës (0.7 për qind); xeheroret dhe guroret e tjera (0.5 për qind); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (0.2 për qind); dhe prodhimi i mobilie (0.1 për qind).

Sipas ASK-së, krahasuar TM2 2020 me TM2 2019, çmimet e prodhimit u ulën në një mesatare prej (-1.5 për qind). "Rënie më të mëdha, sipas degëve të veprimtarive ekonomike, vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-39.1 për qind); prodhimi i produkteve minerale jometalike (-6.0 për qind); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t. (-4.8 për qind); prodhimi i metaleve (-4.7 për qind); prodhimi i pijeve (-



3.3 për qind); prodhimi i mobilie (-1.4 për qind); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-1.1 për qind); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-1.0 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (-0.8 për qind); dhe prodhimi i letres dhe produkteve prej saj (-0.2 për qind)", është

thënë në raportin e ASK-së, duke u shtuar se rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej saj (7.7 për qind); mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove (7.5 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie:

prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse (4.4 për qind); prodhimi i produkteve kimike (3.7 për qind); prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (1.8 për qind); prodhimi i pajisjeve elektrike (1.0 për qind); dhe xeheroret dhe guroret e tjera (0.9 për qind).

## Dëmtohet linja TM Badoc-Prishtinë, mbesin pa ujë disa zona në kryeqytet



PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Kompania Rajonale Ujësjellësi "Prishtina" ka njoftuar se është dëmtuar linja TM Badoc - Prishtinë. KRU "Prishtina" përmes një njoftimi për media ka thënë se kjo linjë është ndër arteriet kryesore të furnizimit të qytetit me ujë. "Të nderuar konsumatorë, me shumë keqardhje ju njoftojmë se duke provuar t'i mbajmë kapacitetet maksimale në furnizim, me qëllim të furnizimit të pikave të larta, mbrëmë rreth orës 24:00 kemi pasur dëmtim të linjës

TM Badoc - Prishtinë, linja e çelikut DN 600 mm. Për fat të keq, kjo linjë është nga më të vjetrat në funksion, njëkohësisht është edhe një nga arteriet kryesore të furnizimit të qytetit me ujë, duke përfshirë në degëzimin fillestar për Graçanicën, pastaj Hajvalinë, Veternikun e, mbi të gjitha, Prishtinën me zonat e Matit, Bregu i Diellit dhe Aktashi një pjesë", thuhet në njoftim.

Më tej, KRU "Prishtina" ka theksuar se ekipet e

mirëmbajtjes dhe operimit, së bashku me drejtoreshën teknike, janë në terren duke punuar në alternativë tjetër për t'i furnizuar zonat e sipërme të Bregut të Diellit, zona që kohët e fundit kanë pasur probleme me furnizim me ujë. "Ju kuptojmë për shqetësimin që keni, por ju lutem na kuptoni edhe ju neve pasi që po bëjmë çmos që ju mos ta ndieni mungesën e ujit në këtë kohë pandemie. Ju falënderojmë dhe kërkojmë mirëkuptim", thuhet në njoftimin e KRU "Prishtina".



## Qeveria po rrezikon që rreth 100 mijë punëtorë të mbesin pa punë



PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - "Mospërkrahja e mjaftueshme e qeverisë është duke sjell në kolaps biznesin i cili, edhe përkundër vullnetit që t'i mbajë në punë punëtorët që shumë vite, detyrohet t'i largojë nga puna. Për këtë arsye është shumë e nevojshme që Qeveria dhe Kuvendi ta ndryshojnë qasjen ndaj biznesit me ndryshimin e ligjeve dhe rritjen e përkrahjes ndaj bizneseve", kështu u tha gjatë takimit që

përfaqësues të Odës së Afarizmit të Kosovës patën me kryetarin e Sindikatës së Pavarur të Sektorit të Punëtorëve Privat, Jusuf Azemi. Temë kryesore e diskutimit përgjatë këtij takimi ishte gjetja e një mundësie për moslargimin e punëtorëve nga vendi i punës, pasi që kjo bartë në vete një risk të madh. Pandemia Covid-19 ka atakuar më së tepërmi sektorin privat, pra vetë bizneset. Për këtë arsye

shqetësimet janë ngritur si nga ana e OAK-së ashtu edhe nga vetë Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat e Kosovës. Krasniqi dhe Jusufi kanë bërë thirrje publike për të marrë përkrahje nga Qeveria e Kosovës, përkrahje kjo për të cilën me të vërtetë sektori privat ka shumë nevojë. Në të kundërtën, shumë biznese do të shkojnë drejt falimentimit dhe mijëra qytetarë do të mbesin pa vende pune. Nëse

situata vazhdon të jetë e njëjtë, pa ndonjë përparim në ditët në vazhdim, rreth 100 mijë punëtorë rrezikohet të mbesin të pa punë. Në këtë takim u tha se për këtë kërkohet subvencione nga shteti, në të kundërtën do të rrezikohet mirëqenia e qytetarëve tanë dhe të hyrat e shtetit. Në mes të tjerash, OAK-u vazhdon ta ngrehë si çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, që secili punëtor

duhet të jetë i pajisur me sigurimin shëndetësor dhe sigurimin në punë. Ndërsa kryetari i SPSPK-së bëri me dije se gjatë javës së ardhshme do të mbajnë protesta para Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak të mungesës së përkrahjes nga ana e shtetit për punëtorët e sektorit privat, konkretisht për pagesat shtesë të punëtorëve teknik-shëndetësorë.

## Ministria e Bujqësisë avokon interesat e sektorit të qumështit



PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Shefi i kabinetit i ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Petrit Abdullahu, ka pritur në takim shefin e kabinetit të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë, Albert Maxhuni, si dhe shefin e Divizionit të Shëndetit Publik në kuadër të AUV-së, Flamur Kadriu, ku biseduan për

problemet me të cilat përballet sektori i qumështit në vendin tonë. Gjatë takimit saktësisht është biseduar për problemet me të cilat ballafaqohen prodhuesit, përpunuesit dhe grumbulluesit e qumështit, ku shefi i kabinetit të MBPZHR-së ka kërkuar nga shefi i Kabinetit të MTI-së, që kërkesa në lidhje me ndarjen e produkteve me origjinë bimore

dhe origjinë shtazore të fillojë të aplikohet së bashku me inspektorët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në marketet vendore. Abdullahu ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim, ku gjatë inspektimit në markete vendore dhe në sektorët ku koncentrohen këto produkte të jetë të pranishëm edhe

personalisht si përfaqësues i interesave të bujqve dhe agro-përpunuesve vendorë. Në takimin e mbajtur u diskutua edhe kërkesa tjetër e parashtruar nga shefi i kabinetit i MBPZHR-së që të sigurohet hapësira ligjore dhe mundësitë që disa prej produkteve të qumështit, nga prodhuesit vendorë, me afat të qëndrueshmërisë të merren si

rezerva shtetërore nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. MBPZHR-ja vazhdimisht do të avokojë, për të gjithë sektorët që lidhen me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht që të jetë sa më afër bujqve tanë, në këtë kohë kur aktivitetet e tyre bujqësore janë vështirësuar.

# Haziri: Java e fundit e qetë dhe me ulje të lehtë të rasteve pozitive

GJILAN, 4 SHTATOR (ER) - Komiteti i emergjencave për parandalimin e pandemisë globale Covid-19 në Gjilan e ka vlerësuar të qetë gjendjen në 24 orët e fundit, ku janë shënuar vetëm tri raste pozitive dhe një numër i madh i të shëruarve, mirëpo edhe më tutje kërkohet respektimi i masave mbrojtëse për të vazhduar me ulje të rasteve pozitive deri në pikën zero.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili ka udhëhequr takimin me përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, ka konfirmuar trend të lehtë në rënie me raste pozitive, gjithashtu edhe lehtësime për menaxhimin e situatës nga institucionet shëndetësore,

sepse numri i pacientëve me Covid-19 është më i vogël.

“Javën e fundit kemi një trend të uljes së lehtë të rasteve pozitive. Kjo nuk do të thotë se infeksioni nuk është kërcënues siç ka qenë. Gjendja e përgjithshme në Gjilan nga 869 raste pozitive sa kemi të regjistruara që nga 13 marsi, prej tyre 681 janë shëruar plotësisht deri sot, 39 raste kanë vdekur, ndërsa 149 raste janë aktive dhe nën monitorimin e vazhdueshëm nga emergjencat civile dhe mjekët, e prej tyre 44 janë të hospitalizuara dhe me gjendje të qetë në aspektin shëndetësor. Mostra në pritje të rezultateve nga IKShP janë 55”, ka thënë Haziri.

Ai ka potencuar se në Gjilan katër laboratorë janë duke i



trajtuar rastet me teste serologjike, ndërsa Komuna e Gjilanit është duke koordinuar

punën për vendosjen e një aparati në QKMF, ku 5 000 mostrat e para do të jenë falas

për qytetarë që mbulohej nga ana e komunës, mirëpo pa testin PCR nuk do të trajtohen.

## Filloi hapja e rrugës Ngucat - Bllacë që lidh komunat Malishevë - Suharekë

MALISHEVË, 4 SHTATOR (ER) - Në pjesën e fshatit Ngucat edhe zyrtarisht kanë filluar punimet për hapjen e rrugës Ngucat - Bllacë, e cila lidh këta dy fshatra, por është edhe një rrugë më shumë që lidh Komunën e Malishevës me atë të Suharekës. Në fillimin e punimeve ishin të pranishëm deputeti i Kuvendit të Kosovës, Mërgim Lushtaku, si propozues i këtij amendamenti për futjen në buxhet, dy kryetarët e komunave përkatëse, Ragip Begaj dhe Bali Muharremaj, përfaqësues të fshatit Ngucat dhe qytetarë të tjerë. “Jam i kënaqur që jam këtu, në fillimin e hapjes dhe rregullimit të rrugës Ngucat - Bllacë. Ka qenë një investim i nevojshëm për ne të gjithë, e sidomos për banorët e kësaj pjese pasi kjo rrugë e shkurton rrugën aktuale për disa kilometra, por edhe ka qenë një rrugë ku ka lëvizur UÇK-ja gjatë luftës. I falënderoj të gjithë ata që janë angazhuar për ndërtimin e kësaj rruge, përfshirë edhe deputetin Lushtaku”, tha kryetari Begaj. Ndërsa deputeti Mërgim Lushtaku ka thënë se është




krenar që ka filluar të realizohet ndërtimi i kësaj rruge e cila është kërkesë e banorëve të dy fshatrave dhe fshatrave të tjerë si dhe kryetarëve të dy komunave. “Kjo rrugë nuk lidh vetëm dy fshatra, por edhe dy qytete. Kjo rrugë ka edhe rëndësi strategjike dhe historike, pasi ka qenë në shërbim të luftës çlirimtare dhe e kemi ndier obligim si deputetë që ta mbështesim këtë projekt për ndërtimin e rrugës Ngucat - Bllacë”, ka thënë deputeti Lushtaku me rastin e fillimit të punimeve në hapjen e rrugës. “Ky projekt ka qenë një amendament që e kam propozuar dhe ndihem

jashtëzakonisht mirë që ka filluar të realizohet”, ka thënë ai, duke shtuar se realizimi i projektit do të mbikëqyret deri në realizimin e plotë, pasi e ndien edhe obligim moral që projekti të realizohet ashtu siç është paraparë. Edhe kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, i ka uruar të gjithë banorët e kësaj pjese, e sidomos banorët e Ngucatit dhe të Bllacës, për rregullimin e kësaj rruge që lidh të dy vendbanimet dhe një lidhje më shumë mes dy komunave. Rruga Ngucat - Bllacë është e gjatë 2 kilometra e 613 metra dhe mundësohet nga Ministria e Infrastrukturës.

## Komuna e Ferizajt, qytetarëve: Mos ndizni zjarre në Parkun e Pishave

FERIZAJ, 4 SHTATOR (ER) - Komuna e Ferizaj u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos ndezin zjarre përkaj dhe në Parkun e Pishave në vargmalet e Rahovicës dhe Mirosalës, në të kundërtën ka paralajmëruar se do të veprojë me forcën e ligjit, konform rregullativës ligjore në fuqi, duke shtuar kontrollin e inspektoratit për të shqiptuar gjoba për ndotësit dhe shkatërruesit e mjedisit.

“Ky apel vjen si pasojë e shtimit të rasteve ditët e fundit të zjarreve të ndezura në këtë hapësirë, që rrezikon jo vetëm mjedisin, por edhe të gjitha pronat përreth nga pakujdesia e qytetarëve. Rikujtojmë se ky investim që u përrua ditë më parë paraqet një pikë të re të rëndësishme të turizmit malor në Ferizaj”, është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Ferizajt.



## Në Spitalin e Pejës po trajtohen 60 pacientë me Covid



PEJË, 4 SHTATOR (ER) - Në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës janë duke u trajtuar 60 pacientë me Covid-19, prej tyre 15 janë në gjendje më të rëndë shëndetësore. Atje gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar dy pacientë me Covid-19. 41 pacientë janë në oksigjeno-terapi dhe nga këta 15 pacientë janë në

gjendje më të rëndë. Nga Personeli i Spitalit aktualisht janë të infektuar dy mjekë, katër infermierë dhe tre punëtorë të shërbimeve teknike. Gjatë 24 orëve të fundit në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, 190 pacientë kanë marrë trajtim emergjent shëndetësor.

# NËNSHKRIMI I NJË MARRËVESHJEJE TË PARALAJMËRUAR!



**Behxhet Sh.  
SHALA-BAJGORA**

Para një viti presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pati deklaruar se pikërisht në këtë kohë do të nënshkruhet marrëveshja finale me Serbinë për normalizim të marrëdhënieve dhe njohje të detyrueshme reciproke në oborrin e Shtëpisë së Bardhë në Uashington, në Kopshtin e Trëndafilave e cila do të noterizohej nga kryenoteri i botës, presidenti i ShBA-së, Donald Trump. Aktorët apo nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje do të ishin Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq. Realisht kjo marrëveshje ishte vdekje e paralajmëruar politike për të dy presidentët. Hashim Thaçi u linçua publikisht nga opozita në Kosovë dhe nga e ashtuquajtura shoqëri civile si dhe nga mediat e varura dhe shumë të varura në emër të mbrojtjes së pavarësisë që nuk

ekzistonte as si formë e lëre më si përmbajtje. Aleksandar Vuçiqi sulmohej nga opozita, ndonëse ishte në flirtim pasionant me Kishën Ortodokse Serbe që ishte dhe është faktor përcaktues për të gjitha zhvillimet në Serbi. Aleksandar Vuçiq dhe Otac Teodosije kishin dhe kanë përparësi krahasuar me më parë Thaçin e tash Hotin për faktin se po bisedojnë dhe do të nënshkruajnë marrëveshje e cila në çdo aspekt ka të bëjë me Kosovën e jo me Serbinë. Aleksandar Vuçiqi, një kriminel lufte i viktimizuar, po e luan rolin si një serb tipik i llojit të Nikolla Pashiqit, gënjeshtër si përmbajtje e ka ambalazhuar me një cipë të rivendosur të virgjinitetit të pafajësisë e që bota po e pranon si të tillë, jo se nuk ka të dhëna se çka ka bërë Serbia në Kosovë, por se oportunitizmi politik dhe interesi po e kërkojnë këtë. Po Kosova, ku është në këtë mes: Realisht ekipi kosovar që nga fillimi nuk e ka përcaktuar qëllimin e as vijat e kuqe ndaj Serbisë sikur që ka dëshmuar një "fleksibilitet" deri në përlulje dhe dorëzim ndonëse i kanë pasur dhe i kanë të gjitha faktet për qëndrim ndryshe. Kanë dëshmuar mungesë të

dinjitetit, kompetencës dhe përgjegjësisë sikur të bisedonin për shkretëtirën e Saharës dhe jo tokën e Kosovës. Pa asnjë nevojë u hap çështja e shkëmbimit të territoreve dhe çështje të tjera të cilat jo që e thelluan inferioritetin e pozitës negociuese të Kosovës, por i thelluan edhe çarjet brendashqiptare. Hashim Thaçi, me një vendim politik të Gjykatës Speciale, u eliminua nga roli që e kishte në bisedime, u harrua brenda një dite nga Grenelli dhe Borrelli, prandaj Avdullah Hoti tash do ta nënshkruajë marrëveshjen e ditur një vit e më parë në Kopshtin me Trëndafilat në Shtëpinë e Bardhë. Bisedimet dje dhe sot në Uashington u mbuluan me një vello të misteriozitetit dhe dramacitetit, ndonëse ka kohë që ishte draftuar dhe se askush nuk e ka pyetur dhe as që e pyet delegacionin e Kosovës, kurse Serbinë e dëgjojnë me më shumë kujdes. Realisht, praninë e presidentit Donald Trump e bën alfa dhe omega e këtij takimi duke luajtur me ndjenjat e qytetarëve. Para një viti është ditur se Donald Trumpi do të jetë i pranishëm, disa minuta derisa të nënshkruhet kjo marrëveshje.

Prania e presidentit Donald Trump më shumë duhet të konsiderohet si presion ndaj palëve se si përkrahje dhe si pjesë e fushatës elektorale për zgjedhjet presidenciale në ShBA. Është shumë më e rëndësishme përmbajtja e marrëveshjes sesa a do të jetë Donald Trumpi i pranishëm gjatë nënshkrimit a jo. Dikush më tha se për një besimtar islam arritja më e madhe është pelegrinazhi në Mekë, për një të krishterë është pelegrinazhi në Vatikan, kurse për një politikan kosovar është Shtëpia e Bardhë në Uashington. Varësisht në çfarë cilësie ju thërrasin, mendoj unë. Sot është shumë atraktive ta vizitoni Alkatrazin si vizitor, por nuk ka qenë aspak atraktive nëse keni qenë i burgosur aty. Nëse po arrihet një marrëveshje në Uashington, pse u dashka pas 2-3 ditëve të takohen në Bruksel, Aca dhe Dulla? Përralla janë pohimet e Dullës se me Serbinë do të bisedohet vetëm për njohje reciproke, do të bisedohet edhe për arat e Dullës në Ratkoc. Me vetë faktin se jeni ulur në tavolinën e bisedimeve nënkupton se keni hequr dorë nga mbrojtja e pozicioneve të forta. Serbia në çdo aspekt do

të ndahet më mirë se Kosova, qoftë për shkak të oportunitizmit të bashkësisë ndërkombëtare, ndoshta edhe më shumë për shkak të injorancës sonë. E kuptoj opozitën e Kosovës që nuk ka pranuar të jetë pjesë e ekipit të Kosovës, por nuk e kuptoj pse nuk ka pranuar të marrë pjesë në takime konsultative para se të shkohet në Bruksel dhe Uashington. Në ekipin e Kosovës që është në pritje të përjetimit të orgazmës për shkak të pranisë së presidentit Donald Trump gjatë nënshkrimit të marrëveshjes ka të tillë që nuk e kanë shkrepur as edhe një pordhë të vetme për lirinë dhe shtetin e Kosovës, kurse tani duan të na bindin se i kanë prapënicat me mbushje bërthamore! Kurse deklarimi i një partie opozitare, se nuk mund të nënshkruhet asnjë marrëveshje pa partinë fituese të zgjedhjeve të fundit, i ngjan tregimit kur ujku e ha gomarin e ai thotë inshallah jam ëndërr. Proceset ecin dhe nëse nuk jeni pjesë e tyre, janë dhe bëhen të papërsëritshme! Tash vetëm na ka mbetur të mësojmë për pasojat dhe të bëjmë përpjekje t'i menaxhojmë me sa më pak dëme! Politika krijon injorantë, kurse historia nuk i fal ata! Uroj ta kem gabim!





Flet akademik Muhamedin Kullashi (4)

## Vdekjen e filozofisë e shpallën rrymat pozitiviste e scientiste



Intervistoi:  
**Prof. dr. Haqif MULLIQI**

Muhamedin Kullashi është intelektual *par excellence*. Është kënaqësi e madhe që të bisedosh me të dhe të përballësh me elokuencën dhe poliedrizmin e tij. Është akademik. Disa vjet ka qenë profesor në Universitetin "Paris 8" në Francë. Është filozof i shquar, vlerësimet për të cilin janë bërë edhe jashtë hapësirave tona. Profesor Kullashi është autor i një numri të madh të veprave nga fusha e filozofisë e që, sipas mendimit tonë, janë libra që ngërthejnë në vete: filozofinë, sociologjinë, ontologjinë, antropologjinë, teorinë e artit dhe poetikën e tij. Krahas angazhimeve si profesor i njërit prej universiteteve më të njohur në botë, atij "Paris 8", profesor Kullashi kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë edhe për zhvillimin e filozofisë në Universitetin e Prishtinës.

Ajo që na ka mahnitur gjithmonë është se Muhamedin Kullashi është edhe njohës i pashoq i fushës së dramaturgjisë dhe teatrit. Titujt e librave të tij janë të shumtë dhe, prej rreth katër dekadash, si rrallëkuajt, veprat e tij janë botuar edhe në gjuhën frënge. Profesor Kullashi disa vite ka shërbyer edhe ambasador i parë fuqplotë i Republikës së Kosovës në Francë. Këtë intervistë me të e kemi realizuar për revistën për letërsi, kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".

*Çfarë mund të thuhet më konkretisht për filozofinë sot? A e ka filozofia sot atë fuqi të cilën e kishte gjithmonë?*

**KULLASHI:** Pikërisht kjo ka ndodhur edhe me mendimin filozofik të Michel Foucaultsë. Ai është, padyshim, një nga mendimtarët më të mëdhenj të shekullit XX. Veprat e tij kanë ushtruar dhe vazhdojnë të ushtrorjnë ndikim të rëndësishëm në shumë vende, kryesisht në Francë, Gjermani, Itali, Angli, ShBA dhe Amerikë Latine. Frytshmëria e ndikimit të tij shfaqet jo thjesht në shtrirjen e vazhdueshme të pikëpamjeve të tij në disa kontinente, por me *nxitjen* e hulumtimeve shkencore në

fusha të ndryshme (filozofi, histori, psikologji, sociologji, politikologji, antropologji, drejtësi, letërsi), duke u nisur nga *problematizimi* i temave që i kishte analizuar (çmenduria, pushteti, burgu, seksualiteti, urbanizmi, arti dhe letërsia, subjektiviteti). Sa për t'i ilustruar përmasat e këtij ndikimi do të mjaftonte këtu një shembull që duket marginal në opusin e Foucaultsë. Është fjala për analizat kritike të raporteve që thuren midis politikës dhe liberalizmit ekonomik në botën e sotme, të botuara në përmbledhjet e ligjëratave të mbajtura në *Collège de France*, *Siguria, territori dhe popullsia* (1977-1978) dhe *Lindja e biopolitikës* (1978-1979). Këto ligjëratat do të jenë gurë frymëzimi jo vetëm për simpoziume dhe botime të shumta, në dy dekadat fundit, por edhe për zhvillimin e një rryme të tërë të hulumtimeve të quajtura *governmentality studies*, që morën hov së pari në ShBA (Colin Gordon, Graham Burchell, Piter Millar), më vonë edhe në Angli (Michel Dean), Gjermani (Thomas Lemeke, Susanne Krasmann) e në Francë (Sylvain Meyet, Thomas Ribemont). Njësoj, edhe hulumtimet

sociologjia e mjekësisë si dhe kërkimet juridike mbi të drejtën penale dhe institucionet penale shumë shpesh iu referohen analizave të Foucaultsë, e të mos flasim për kërkimet etike, në veçanti temat e "bregës për vete", e subjektivitetit dhe procesit të subjektivizmit.

Foucault shkroi shumë edhe për poezinë (Rimbaud, Mallarmé, Hölderlini), për romanin (Blanchot, Klossovski, Roussel), për tragjedinë (Shakespeare, Racine, Corneille), për dramën (Artaud), për letërsinë dhe veprën letrare, për pikturën (Velasquez) dhe për filmin. Këto shkrime u bënë tema për kritikën letrare dhe gurrë frymëzimi për meditimet mbi artin dhe letërsinë, në shumë vende. Meditimet e Foucaultsë mbi letërsinë si "qenie e ligjërit" (*être de langage*), mbi *përvojën* e shkrimit dhe ligjërit, mbi çmendinë dhe veprën letrare si "mungesë e veprës" (*l'absence d'oeuvre*), si karakteristikë e mënyrës së të qenurit të shkrimit modern, mbi "hapësirën imagjinare" që sajohet me aktin e shkrimit, mbi letërsinë si "mërmërimë" (*murmure*), për ligjërimin letrar si "ligjërim i shumëfishimit të sipërfaqeve", për

shpërbërjen dhe shumëfishimin e subjektivitetit nëpërmjet aktit të shkrimit, hapën shtigje të reja të mendimit mbi letërsinë.

### Letërsia dhe filozofia

*Një arsye për shkak të së cilës mund të flasim për një kufi të paqartë ndërmjet filozofisë dhe letërsisë qëndron në faktin se ndërmjet tyre ekzistojnë disa puqe dhe gërshetime tematike, me çfarë personalisht e kuptoj jo vetëm interesimin për probleme të njëjta, por edhe ndikimin e ngjashëm, kognitiv të lexuesi ngaqë edhe filozofia dhe letërsia në mënyrë parësore merren me njeriun dhe përvojat e tij, duke i shestuar me këtë rast disa prej nocioneve bazike si dhe të koncepteve me të cilat ne e përshkruajmë veten tonë dhe botën në të cilën jetojmë.*

**KULLASHI:** Filozofia dhe letërsia gjatë shekujve janë puqur dhe janë gërshetuar shpesh në mënyra shumë të ngushta në shumë vepra qofshin ato filozofike, qofshin letrare, poetike e dramaturgjike. *Poema* e Parmendit mbi natyrën, edhe dialogët e Platonit shquhen me një bukuri mahnitëse estetike dhe me një stil të shkrimit që ka

ngashënjyer lexuesit gjatë shekujve.

Autorët bashkëkohorë që janë marrë me historikun e raporteve midis filozofisë dhe letërsisë kanë trajtuar në veçanti me forma të ndryshme të imagjinare artistike. Edhe në mesjetë kishte tekste shumë të bukura ku gërshetoheshin filozofia dhe poezia. Në kohën e Rilindjes evropiane (XIV-XVI) ky gërshetim diktohet në tekstet e shumë autorëve, bie fjala te Dante Alighieri, Mirandola e Machiaveli. Ky gërshetim shkëlqen më vrullshëm në shekullin XVIII, në veçanti në filozofinë dhe letërsinë franceze: fjala vjen në veprat e Diderotsë (si *Ëndrra e D'Alamberit*), të Rousseaus (*Ëndërrimet e shëtitësit të vetmuar*, *Rrëfimet*, *Eloisa e re*.) Libri i parë të cilën e kam përkthyer nga frëngjishtja në gjuhën shqipe ka titullin *Dialogë filozofikë (Rilindja, Prishtinë, 1979)*. Me këtë titull kam përmbledhur tre dialogë të filozofit francez Denis Diderot (Dëni Didëro): *Shëtitja e skeptikut apo shëtitoret*, *Biseda e d'Alembertit me Diderotin* dhe *Ëndrra e D'Alembertit*. Parathënia ime ka për titull *Filozofia si dialog*. Diderot është një nga mendimtarët më të mëdhenj të shekullit XVIII në Evropë. Në veprat e veta filozofike ai ndërlihd me mjeshtri mendimin e thellë konceptual me imagjinaren e begatshme artistike. Goethe (Gëte) për një vepër tjetër të Diderotsë (*Nipi i Rameausë*) shkruante: "Çfarë koherence në këtë dialog!... Gjithçka është e lidhur këtu me një gjerdan të padukshëm e, megjithatë, ekzistues; një gjerdan i çelniktë të cilin e mbulon para syve tonë një kurorë lulesh". Marksi në një letër ia rekomandonte

Engelsit ta lexonte këtë vepër madhore dhe citonte aty disa komente të Hegelit.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i këtyre dialogëve lidhet me metodën e kërkimit të njohurive që kanë një nivel të vërtetësisë. Kjo vërtetësi për njeriun dhe botën, sipas Diderotsë, përtej paragjykimeve, iluzioneve e vetëmashtrimeve, mund të arrihet me ballafaqimin e argumenteve të pikëpamjeve kyçe. Secili nga personazhet e dialogut përfaqëson rëndom një botëkuptim të përpunuar me vëmendje e durim. Çdonjëra nga këto pikëpamje duhet të ballafaqohet nëpërmjet një *dialogu polifonik*, me problematizimet dhe kontestimet që dalin nga pikëpamjet e tjera. Kësisoj, njohuritë që mund të pretendojnë në një vërtetësi të caktuar nuk mund t'u ikin sprovave të dialogut kritik.

Në saje të hulumtimit të njohurive filozofike dhe shkencore-natyrore të kohës së tij, në veçanti Diderot zhvillon një konceptcion të thelluar mbi njeriun e natyrën që tejkalon kufizimet e materializmit mekanicist, me idenë mbi zhvillimësinë e botës, mbi ndryshimësinë e saj të vazhdueshme. Kësisoj, në shkrimet e tij gjithësia paraqitet si një sistem i ndërlikuar që ndryshon vazhdimisht në çdo pjesë të saj. Shkrimi filozofik këtu përshkohet me atë "kurorë lulesh" të imagjinare artistike për të cilën flet Goethe.

Autorët bashkëkohorë që janë marrë me gjurmimin e lidhjeve midis filozofisë dhe letërsisë kanë vënë në pah shpesh se në shekullin XIX janë shquar, në veçanti poetët gjermanë Hölderlini dhe Novalis me kultivimin e mendimit

filozofik-poetik. Ndërkaq në Francë, Victor Hugo dhe Alfred de Vigny dallohen në kohën e romantizmit. Si vepra poetike të Hugos janë cituar shpesh *Soditjet* dhe *Legjenda e shekujve*, vepra ku "historia paraqitet si filozofi e llojshmërisë së shpirtave, popujve, qytetërimeve" (Viellard Baron). Kurse te poezitë e Vignys flitet po kështu për një filozofi të historisë dhe pikëpamje etike stoiciste. E më vonë, me këto tipare shquhet poezia e Mallarmes, Baudelaireit dhe Rimbaudsë.

Te Goethe (Gëte) ideja e një letërsie botërore (*Weltliteratur*), e cila nuk implikonte heqjen e letërsive nacionale, është një ide filozofike mbi letërsinë. Goethe kishte vërë në pah në shkrimet e veta se "ideja e një vizioni të madh mbi botën realizohet brenda letërsisë" e cila arrin një nivel botëror. Kurse Marcel Proust në veprën e vet madhore *Në kërkimin e kohës së humbur* flet për një "filozofi estetike e morale". Bernard Grasset dhe Jean Wahl shquhen si "filozofë artistë" dhe autorë të veprave të shumta nga fusha e filozofisë. Kurse Sartre është, siç e dini, filozof dhe shkrimtar i romaneve, dramave, novelave. Stili i tij në shkrimet filozofike (*Kritika e mendjes dialektike*; *Çështjet e metodës*) ka edhe dellin poetik e letrar. Kjo vlen edhe për tekste filozofik-politike *Situatat* në njëmbëdhjetë vëllime. Ajo që lë përshtypje të veçantë në këto shkrime të Sartrit është zotësia e tij që çështjes universale - lirisë së njeriut në shoqëri - t'i japë dimensionet e saj konkrete, specifike, në çdo situatë të cilën e analizon. Lidhja midis analizës konceptuale të sundimit të

stalinizmit në Çekosllovakë, hetohet shumë mirë në artikullin e gjatë (50 faqe) *Socializmi që erdhi nga të ftohtit*. Fjala vjen, ja si e përshkruan situatën e shkrimtarëve çekosllovakë brenda sistemit stalinian: *Këtu stalinizmi si "sistem i verbër dhe i shurdhër për dimensionet e mirëfillta njerëzore", sistem i cili e redukton njeriun në një sistem mekanik: jo vetëm në teori, por edhe në praktikën e përditshme. Sistemi stalinist "është i detyruar t'i përdorë njerëzit, por nuk ka besim tek ata, i përbuz dhe i urren: ai vepron në atë mënyrë që mosbesimi, përbuzja dhe urrejtja t'i përcaktojnë marrëdhëniet e njerëzve ndërmjet vete dhe individit me vetveten". Ideologjia staliniste, e maskuar me një humanizëm të zbehtë marksian, në vend se ta ndihmojë të kuptuarit kritik të shoqërisë, të pozitës së njeriut brenda saj, i mjegullon dhe i mistifikon raportet shoqërore. Ajo është për Sartrin një "mendim i mineralizuar" të cilin e vendosin si "një rrasë varri në një kokë të shqetësuar, ai mbetet aty, i rëndë, inert, qetësues, duke i ndrydhur përsiatjet dhe dyshimet, duke i kufizuar lëvizjet spontane të jetës në një gumëzhitje të parëndësishme insektesh". Në atë masë sa të menduarit dhe vetëdija përkufizohen te Sartri me transparencën dhe fluiditetin, "minerali" dhe "rrasa" prej guri janë mohim i vet natyrës së të menduarit. Atë që nuk e gjejmë në analizat sociologjike dhe politologjike për stalinizmin, Sartri na ofron këtu me procedimet dhe me mjetet e veta letrare e filozofike, aspekte të një realiteti social. Ai e ndriçon përjetimin e atij realiteti nga*

*shkrimtarët çekë e sllovakë edhe në këtë mënyrë: "Ata e ndienin veten jorealë në një shoqëri joreale dhe ceremoniale e të trishtueshme, si viktima, dëshmitarë apo bashkëfajtorë të një farse monumentale dhe të ankthshme, valëviteshin si marioneta absurde në një mjedis të strukturuar nga një absurditet i thellë, në atë mënyrë që çdo orvatje për t'iu adaptuar asaj situatë apo për ta ndryshuar atë, ishte që nga fillimi e absurdizuar".*

Bergsoni, ndërkaq, thoshte se filozofi mund të mos jetë muzikant, por ai është shkrimtar në *Dy burime të moralit dhe religjionit*. Kurse Heideggeri në tekstin *Përfundimi i metafizikës dhe poezia*, në saje të një analize të thellë vë në pah se të menduarit filozofik dhe poezia kanë nevojë njëra për tjetrën për t'i realizuar synimet e tyre. Veç të tjerash, ai e ilustron këtë nevojë të komunikimit edhe në saje të shqyrtimit të lidhjeve midis poezisë filozofike të Hölderlini dhe filozofisë poetike të Nietzsches.

*Çfarë domethënie kishte për ju ligjërimi i filozofisë në Departamentin e Filozofisë në Universitetin "Parisi 8"?*

**KULLASHI:** Për mua ishte nder i veçantë kur u pranova në vitin 1992 në Departamentin e Filozofisë në Universitetin "Parisi 8". Ky departament u themelua në vitin 1969 nga filozofi i shquar Michel Foucault. Ai tuboi rreth vetes filozofët Gilles Deleuze, Jean-François Lyotard, François Chatelet, Michel Serres. Ishin këta emrat më të mëdhenj të filozofisë bashkëkohore franceze. Filozofë që me veprat e tyre arritën famë botërore dhe



ndikim të fuqishëm në krijimtarinë filozofike jo vetëm në Evropë, por edhe në ShBA dhe Amerikë Latine, në veçanti. Pjesë e këtij Departamenti u bënë, në vitet '70, edhe filozofët e njohur Jacques Rancière, René Chéreau e Alain Badiou. Veprat e këtyre filozofëve u përkthyen në shumë gjuhë, në disa kontinente. Në vitet '80 këtij Departamenti iu bashkuan edhe Jacques Poulain, Alain Brossat, Jean-Louis Déotte, Stéphane Douiller, Patrice Vermeren, Jean-Pierre Marcos, Ninon Grangé.

Departamenti shquhej, në përmasa ndërkombëtare, me një jetë intensive kërkimore, me simpoziumet ndërkombëtare, me tema filozofike, politike, të artit e kulturës, tema me peshë për shoqëritë bashkëkohore. Merrnin pjesë edhe hulumtues nga vende të ndryshme të Evropës dhe ShBA-së. Ky departament bënte pjesë në UFR (Njësi e Kërkimeve Themelore) Artet, Filozofia dhe Estetika. Autorë të shquar që merreshin me teatrin, kinemanë dhe pikturën ligjëronin në këtë UFR. Kjo bëri që një pjesë e konsiderueshme e simpoziumeve t'u kushtohet temave interdisciplinare, pikëtakimeve të filozofisë me artet.

Në atë Departament ligjërova gjatë 26 vjetëve, deri në pensionim në vitin 2017. Një veçori tjetër e Departamentit të Filo-

zofisë në Universitetin "Paris 8" ishte përbërja ndërkombëtare e studentëve: ata vinin nga vende të ndryshme të disa kontinenteve. Tradita e Departamentit me emra të mëdhenj të filozofisë bashkëkohore ushtronte një atraksion te këta studentë.

Temat filozofike të ligjëratave të mia (në nivelin e parë, nivelin e masterit dhe doktoratës) kishin të bëjnë me filozofinë moderne (Descartesi, Volteri, Rousseau, Diderot), pastaj me filozofinë politike moderne (Machiaveli, Hobbesi, Kanti), me etikën e Kantit dhe konceptcionin e tij mbi historinë, me filozofinë e Nietzsches. Më vonë, në vitet 2000, ligjërova për disa çështje të filozofisë bashkëkohore, në veçanti ato të Foucaultës dhe të Lefortit.

Ndikimi dhe pesha e këtij Departamenti bënë që të jemi të ftuar në shumë konferenca dhe simpoziume në vende të ndryshme të Evropës, në Kanada e Amerikë Latine, por edhe në disa vende të Azisë e të Afrikës. Pjesëmarrja në simpoziume ndërkombëtare shoqërohej me botime të librave me grup autorësh nga vende të ndryshme dhe në gjuhë të ndryshme. Në vitin 1996 e përktheva në gjuhën shqipe veprën e Lyotardit, *Gjendja postmoderne*. Ai ma shkroi një parathënie të veçantë për këtë botim në gjuhën shqipe. Më vonë edhe Claude Lefort ma

shkroi një parathënie të veçantë për zgjedhjen e teksteve të tij, të cilat i përktheva në gjuhën shqipe, me titullin *Demokracia dhe totalitarizmi*. Për mua ishte shumë e rëndësishme, po kështu, që në hapësirën e këtij Universiteti të madh, me më se 30 000 studentë, bashkë me disa kolegë francezë, kemi pasur mundësi të zhvillojmë, gjatë disa viteve, një aktivitet politik rreth konflikteve në ish-Jugosllavi: konferenca e debate dhe botime për agresionet ushtarake të Serbisë në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Kosovë. Natyrisht, në hapësirën publike të Francës pati edhe pole të tjera për aktivitetet të tilla politike si, fjala vjen, rrethi i intelektualëve të mëdhenj francezë pranë revistës së shquar "Esprit". Aty u themelua në vitin 1992 Komiteti i Kosovës, në të cilin bënë pjesë edhe emra të mëdhenj të filozofisë dhe sociologjisë si Paul Ricoeur, Claude Lefort, Edgar Morin, André Glucksmann, Alain Finkielkraut etj.


*Përse ishte i rëndësishëm për ju përkthimi i veprave filozofike në gjuhën shqipe, krahas shkrimeve nga kjo fushë?*

**KULLASHI:** Përkthimi i veprave filozofike për mua ishte një nevojë për ta ndarë me lexuesit shqiptarë kënaqësinë dhe kureshtjen e zbulimit të begatisë së gjurmimeve

filozofike të mendimtarëve të mëdhenj si Diderot (*Dialogë filozofik*), Sartre (*Çështje të metodës*, 1979 dhe *Situatat*, 1986), Lyotard (*Gjendja postmoderne. Raporti mbi dijen*, 1996), Lévinas (*Etika dhe pafundësia*, 2003), Lefort (*Demokracia dhe totalitarizmi*, 1995 në Prishtinë dhe 2018 në Tiranë). I njëjti motivim ka qenë i pranishëm edhe në shkrimet mia nga fusha e filozofisë që nga vitet '70. Ç'është e vërteta, nëse tregojmë kureshtje e vullnet për të komunikuar me vepra të çmuara të mendimit filozofik apo sociologjik, nëse përvetësojmë atë që ato vepra ofrojnë, atëherë ato bëhen pjesë e kulturës sonë, e gjuhës dhe traditës sonë, përtej kufijve gjeografikë. Ato pushojnë të jenë "të huaja" dhe bëhen tonat. Aq më tepër pse kategoritë me të cilat operon filozofia kanë karakter universal, që do të thotë se i përkasin njeriut si njeri së pari, e pastaj ato mund të ndihmojnë në të kuptuarit e veçantive historiko-politike e kulturore të anglezitet, gjermanit apo francezitet. Këtë e dëshmojnë gjithnjë e më shumë, fjala vjen, edhe artistët shqiptarë (piktorë, muzikantë, kantautorë, aktorë dh regjisorë), por edhe matematikanët e rinj me punën që bëjnë, prandaj i pranojnë në vende të ndryshme, në hapësira të ndryshme kulturore. Ndërkaq, mungesa e kureshtjes

intelektuale dhe vullnetit për lexime e kërkime të veprave filozofike, sociologjike e antropologjike, fjala vjen, e cila ndonjëherë vetëjustifikohet me *paragjykimin* se ato vepra janë "të huaja" dhe nuk i takojnë traditës sonë. Në fakt, ky paragjykim përmban në vete *përbuzjen e shqiptarëve*, bindjen se këta nuk janë në gjendje të çilen dhe t'i përvetësojnë njohuritë e nivelit evropian e botëror. Të njëjtin *paragjykim* ndaj shqiptarëve e kemi hasur te nacionalistët serbë, të shpalosur gjatë viteve në revista që pretendonin të kenë nivel teorik. Lidhur me këtë problem Sartre thoshte: Voltairei i takon më shumë një studenti afrikan, nëse çilet ndaj veprës së tij sesa një francezi i cili mbetet i mbyllur ndaj mendimit të Voltaireit e, megjithatë, konsideron se i takon atij në saje të *përkatësisë* së tij nacionale, si një "pronë" nacionale.

*(Intervistën e plotë mund ta lexoni në numrin e tetë të revistës "Akademia" që sapo ka dalë nga shtypi. Revistën e gjeni: në librarinë "Artini", "Dukagjini" dhe në redaksinë e gazetës "Epoka e re" në Prishtinë. Të drejtën e botimit: "Akademia" dhe shtëpia botuese "Armagedoni". Po ashtu, intervistën e plotë mund ta lexoni në vjeggëzën e internetit <https://www.epokaere.com>, në rubrikën Kultura)*



# Motive lirike të mbytura në pëllgje gjaku

(Lulëzim Etemaj & Isuf Sherifi, "Dritë mbi plagë", (sprovë për antologji), poezi, botoi Qendra "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur", Prishtinë, 2020)



**SHEFQET DIBRANI**

*Dritë mbi plagë, ose Sprovë për antologji* është një projekt i veçantë i realizuar nga Qendra Gjenocidi në Kosovë - *Plagë e hapur* me seli në Gjenevë të Zvicrës. Kjo sprovë antologjike ka dalë në qarkullim me rastin e Ditës së gjenocidit, 15 janar, edhe pse i mungon viti, dihet se është botim i sivjetmë (2020).

Antologjia është përgatitur nga Lulëzim Etemaj dhe Isuf Sherifi, poetë dhe të burgosur politikë. Janë përfshirë 51 autore dhe autorë me poezitë e tyre kushtuar luftës, dhunës dhe gjenocidit serb në Kosovë. Gjithsesi një "libër që tematizon gjenocidin serb mbi shqiptarët. Libri, po ashtu, është një homazh artistik ndaj të gjitha viktimave" prandaj, sipas gazetarit për kulturë, Isa Vatovci, ky libër "bartë porosinë për zgjimin e vëmendjes dhe ndëshkimit nga ana e drejtësisë". Poezitë janë përjetime artistike, të shkruara në kohë të ndryshme dhe nga autorë të ndryshëm, të cilët, po ashtu, janë të moshave dhe vendeve të ndryshme.

Përmes këtyre poezive janë shprehur emocione letrare, përjetime dhe përkushtime që manifestohen si ndjenja krijuese e artistike. Së këndejmi, poezitë janë edhe revoltë krijuese "në shenjë homazhi poetik për gjithë të vrarët në Kosovë nga Serbia", ka thënë redaktori i librit, Muhamet Mavraj, në një emision televiziv, madje ai shpresonte se Qendra do të vazhdojë "me botimin e librave edhe të zhanreve të tjera dhe me përkthime të tyre, sidomos për ata libra që flasin për gjenocidin serb në Kosovë".

Kjo sprovë për antologji është një mënyrë letrare e artistike për t'u shprehur kundër "Gjenocidit serb në Kosovë", që sot e kësaj dite mbetet "plagë e hapur" për shqiptarët në Kosovë dhe për popujt e Ballkanit në përgjithësi. Prandaj, "ndriçimi i krimeve serbe njëshekullore, veçanërisht atyre të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë (1997-1999), është detyrë e përhershme jo vetëm e Kosovës, por e gjithë kombit tonë dhe e botës demokratike". Krimi duhet të ndriçohet dhe kryesisht duhen

dënuar, pasi ato "janë shtetërore, të strukturuar, të paramenduara dhe të kryera nga institucionet shtetërore të Serbisë", ka potencuar një nga hartuesit e saj, poeti Lulëzim Etemaj.

Sigurisht janë këto arsye pse poetesha Shefqete Gosalci këtë "Sprovë për antologji" e klasifikon si "Klithmë kundër harresës, për të vërtetën" e, siç shprehet ajo, "Librat jetojnë gjatë, bashkë me ata që i shkruajnë dhe i lexojnë! Edhe kur vjetrohen diçka në to mbetet gjithmonë e re - kujtesa për temat që trajtojnë", madje e ka kategorizuar këtë "sprovë për antologji" si një "Libër me eshtra?", ndërsa "Gjenocidi është një temë universale që, fatkeqësisht, ka rënduar dhe vazhdon të rëndojë popujt të robëruar. Megjithatë, krimi dhe gjenocidi mbeten një mistere për njerëzimin", është shprehur ajo.

Të gjithë e dimë se Serbia vazhdimisht ka bërë spastrimin etnik të trojeve shqiptare, ka bërë shkatërrimin e vendbanimeve, objekteve kulturore, me pretendime për ta shfarosur edhe substancën njerëzore. Këto forma të kimit dhe gjenocidit serb në Kosovë nuk kanë mundur të shpëtojnë pa u regjistruar nga autore dhe autorë, qoftë përmes poezive, prozës, teatrit, fotografive, filmave artistikë e dokumentarë dhe formave të tjera. E kësaj natyre është edhe kjo "sprovë për antologji", e cila ka dalë mjaft mirë e përgatitur qoftë në aspektin teknik, po më shumë në atë tematik e përmbajtjesor, ku përgjatë të cilit përshkruhen format e ndryshme të dhunës, gjenocidit dhe masakrave serbe në Kosovë. "Spastrimi etnik, nuk duhet të heshtet, ai duhet të kanalizohet në pikëpamje juridike dhe politike" dhe natyrisht duhet të gjykohej, nëse dëshirojmë "paqen afatgjatë në Evropë", është shprehur në parathënie poeti Lulëzim Etemaj, prandaj "në funksion të këtij qëllimi, por me karakterin e një homazhi artistik ndaj të gjitha viktimave të gjenocidit në Kosovë, është botuar ky libër me poezi që lidhet vetëm me tematikën e gjenocidit".

## 51 autore dhe autorë me lutje të përshpirtshme

Krimi serb në këtë libër duket si një mozaik. E këtë gjë, nëpërmes shkrimeve letrare, e kanë dëshmuar 51 autorët e prezantuar, disa emra eminentë siç janë Ali

Podrimja e Teki Dervishi, tashmë të ndjerë, si dhe profesorët universitarë: Agim Vinca, Diçe Demiri - Frangu, Xhevdet Bajraj, Salih Bashota, Shaip Emërllahu, Milazim Krasniqi, Muhamet Mavraj, Salajdin Salihu, Lulzim Tafa, Miradije Maliqi, Ag Apolloni dhe ndonjë tjetër. Vend meritore kanë zënë edhe poetët dhe poeteshat tashmë të profilizuara në mesin e të cilëve janë: Adem Gashi, Xhevahir Spahiu, Nexhat Halimi, Arif Molliqi, Teuta Çerkini - Haxhimusa, Berat Armagedoni, Shaip Beqiri, Shaip Emërllahu, Lulëzim Etemaj, Isuf Sherifi, Diçe Lohaj, Mirela Papuçiu, Namik Selmani, Faruk Tasholli, Eduard Frrokaj e të tjerë, të cilët së bashku kanë bërë këtë libër me lutje të përshpirtshme.

Autorët janë prezantuar me një deri në katër poezi, por për shkak të gjatësisë së poezive disa kanë zënë vend më shumë: Në shtatë faqe, Milazim Krasniqi, kurse në gjashtë faqe janë botuar poezitë e Xhevdet Bajrajt dhe të Shefqet Dibranit, të tjerët, nga një deri në pesë faqe të këtij libri. Radhitja e autorëve është bërë sipas alfabetit duke marrë për bazë mbiemrin, gjë që kanë krijuar mozaikun e temave dhe motiveve me një laramani të pranueshme. Me këtë projekt, hartuesit Lulëzim Etemaj dhe Isuf Sherifi e kanë arsyetuar angazhimin e tyre profesional për t'u dukur kjo "Dritë mbi plagë", si një qiri i ndezur për viktimat, një lutje e përshpirtshme për heronjtë e lirisë, ndërsa për gratë e dhunuara, të cilat duhet të jenë gjallë, poezitë janë përkushtime për heroizëm, pasi edhe ato janë

pjesë e kësaj lirie kaq të përvajshme, sakrificë e tyre duhet të shndrisë sikur lulëkuqet e Kosovës, mbase edhe Qendra ka përzgjedhur lulëkuqen si logo të vetën, një harmoni artistike e estetike e krijuar nga të gjitha pamjet.

Më shumë se poezi, janë lutje të përshpirtshme që do të përjetohen thellë, ta lëkundin dhembjen, të bëjnë me nxjerr lotin. Lexuesi, në ndonjë varg a poezi, do ta gjejë veten dhe do ta përjetojë më thellë tragjedinë dhe dramën e lirisë së Kosovës. Aty ku dhembja ka kaluar mbi shpatullat e poeteshave ose poetëve, vargu është i zymtë, mbase si rezultat i përjetimit real të tmerrit nëpër të cilin kanë kaluar. E nëpër këtë shteg erdhi edhe liria që po e gëzojmë, e nëse liria ka dhembje, faje kanë plagët e luftës!... Nëse nëpër vargje përjetohen drithërima, do të thotë se hartuesit kanë realizuar "sprovën për antologji". S'ka dyshim aty-këtu poezitë t'i lëkundin halucinacionet, madje ta rikthejnë frymën e asaj frikës e cila pashmangshëm ka qenë pjesë e luftës, dmth. paraqesin një mesazh real, në anën tjetër ndoshta do të ndikojnë në ndërgjegjësim të atyre që janë dalldisur e, ndoshta, do ta zgjojnë nga letargjia shoqërinë tonë të fjetur.

## Pëllgje gjaku, ofshama të dhembjes dhe motive lirike

Poezitë e autorëve kanë vlerë se vetëm kështu qëndrojnë gjatë.

Këtë kriter më së miri e plotëson poeti Xhevdet Bajraj. Ofshama e tij është sintagmë që lëkund të vdekurit në varre. "E imja është veç dhimbja", pikërisht me këtë varg të trishtuar nis poezinë. Vargu i Xhevdet Bajrajt është ndër më karakteristikët brenda këtij libri, bile edhe më tej... "Kjo poezi s'është e imja/ këto vargje i kanë shkruar ushtarët e armikut/ e imja është veç dhimbja dhe ky vaj që... me ty e ndaj", f. 21.

Natyrisht, ishte tragjika e Fatos Zhuniqit që u gjet i ngrirë në përfaqim të të birit, tamam ashtu siç thotë poeti kur: "dy orë iu deshën njerëzve/ për t'i ndarë babë e bir nga përfaqimi i ngrirë". Kjo metamorfozë e dhembjes e cila shfaqet në këto vargje, përjetohet deri në ekstazë dhe padyshim libri "Dritë mbi plagë", me vetëm poezitë e Xhevdet Bajrajt do të mjaftonte pasi është thënë e tëra. Poezia e këtij autori është e veçantë, është e papërsëritshme, me pak vargje shpreh mesazhe të mëdha. Vetëm dy vargjet e shkëputura nga poezia "Gjellë shqiptare" duhet ta tronditnin planetin! Ky autor më mirë se të tjerët e ka plotësuar qëllimin e hartuesve dhe Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" për të krijuar një mesazh artistik, por kur të mësohet se "Ushtarët e armikut në Kosovë/ kishin meny të pasur shqiptare", qoftë si nuancë e rrëfimit poetik, duhet të shtangemi përpara krimin serb që është bërë në Kosovë. Mjafton të lexohet kjo poezi, mbase antologjike, veçmas refreni: "Dikush kënaqej edhe veç me një kokë të pjekur", në të cilën thuhet




se serbët: "Piqnin e zienin në zjarre shtëpish/ hanin e pinin nga kafka shqiptarësh/ sikur të mos ishin njerëz/ sikur të mos ishim njerëz/ apo jo Zot/ derisa vera i ktheu në dhéun e tyre/ kur u majmën nga vdekja", f. 24. Kjo poezi si tërësi, e bën Xhevdet Bajrajn njërin nga përfaqësuesit më tipik të poezisë së sotme shqipe. Ai ka futur aq thellë ndjenjën në poezi sa nuk ka më fuqi ta heqë dikush nga zemra, nga mendja, qoftë për lirikën e mirë e qoftë për dhembjen e vështirë. Xhevdet Bajraj është bërë poeti më i miri që ka regjistruar e kultivuar ndjeshmërinë në poezi.

Shqetësimin deri në një makth e ndeshim edhe në poezinë e Sali Bashotës, "A jeni gjallë miqtë e mi, po vjen treni i vdekjes", refren i nxjerr nga poezia "Prishtina natën e 31 marsit", f. 27, ndërsa pasthirmra tjetër është klithje: "Populli im midis dy grumbuj gjarpërinjsh këlthet/ Po vdes në shkretëtirën e atdheut të vet". Poeti, edhe në poezinë "Loja e tmerrit", f. 28, ka shprehur trishtimin e tij qysh më 2 prill 1999, rrëfim ky original i atij çasti dhe i atij rasti, të asaj lufte përplot krime, dhunime terror dhe gjenocid.

Sali Beqiraj, në poezinë "Rrëfimet e nënës për vrasjen e babait", f. 29, ka lënë në nëntitull një shënim: "Baba dha shpirt më 13 maj 1999", ka hapur dramën reale të asaj kohe, të atyre rrethanave me të cilat ka prekur edhe ndjenjat e atyre bijve që kishin përjetuar fatin e ngjashëm, (natyrisht duke përfshirë edhe autorin e këtij shkrimi), në mënyrë specifike me vargjet: "Baba kish dhjetë fëmijë/ Një më pak se kopshtin që e pati mbjellë// Në Rozhajë/ Dikush në Shkodër/ Tjetri në Tiranë/ Unë në Ulqin/ Vëllai i vdekur në litar/ Tre në mërgim/ Dhe asnjëri nuk kemi qenë skaj tij/ Kur ka dhënë shpirt". Pa dyshim një përjetim i rrallë, i dhembshëm dhe tejet emocional, sidomos kur të kuptojmë se shumë prindër u gjetën "të kthyer përmbys/ mbi barin e kositur", andaj Zot na mëshiro, po më shumë mëshiroji ata "pleq të strehuar lufte", nëpër male, të cilët kishin qëndruar, ("sigurisht për t'ua varrosur prindërit bijve"), se të gjallët duhej ditur varrin ku e kanë, për t'iu sjellë lule e, pse jo, dikush për t'ua krekosur me fjalime të zjarra?!

Poeti Shaip Beqiri vetëm me shënimin sqarues se "Foshnja njëmuajshe Dituri Deliaj mbeti gjallë në gjirin e gjakosur të nënës së vet të mbytur në trumbën e njërës prej familjeve të masakruara nga bandat serbe më 26 shtator 1998 në Abri të Epërme ndërkaq vdiq pa u bërë as dy muaj të tragjedisë së madhe", f. 32, e ka vënë pikën mbi "i". Vargjet e tjera të kësaj poezie janë shprehje estetike dhe artistike, kuptohet për dramën jetësore të vogëlshes Dituri Deliaj, dymuajshe, të cilën vetëm një poet i kamur me



shprehje letrare mund ta përjetësoj kaq bukur e kaq artistikisht.

Përjetimi i poetit Gazmend Bërlajollit shkon përtej nuancave artistike të çdo vargëzimi mbi krimin serb. Ai në poezinë "Nji tamël ma prunë do gra", f. 33, sjell detajin e vuajtjes në mënyrë origjinale, sidomos pasthirmra në vargun: "... oj nanë, veç po dridhna/ çikën a ma mban?", vargje nga të cilat kuptojmë jo vetëm detajin e përjetimit, por shpërfaq fuqinë e gruas në kohë lufte, sakrificën e saj dhe gjëmën e një prindi para foshnjës që i jepte shpirt. Kjo sakrificë përplot vuajtje që përballohej nga stoicizmi i grave, shpalolet humanizmi i tyre me tërë madhësinë hyjnore, pa të cilën nuk do të kishte kuptim jeta, madje as liria e Kosovës. "Rrugës dikur vjehrra/ Zoti shnosh ty se/ çika, më thotë/ vdiq". Natyrisht, prindit i ka djegur shpirtin për vogëlshen e vet, e për të mos e lënë, e për të mos e hedhur kudo, ai e bartte fëmijën e vdekur në krahë. Sa dhembshëm, sa trishtueshëm. Jo kot thuhet se shpresa vdes e fundit! Në anën tjetër, instinkti i grave shëruese dhe tambli i tyre mëkues kanë bërë mrekullinë në kohë lufte, kur: "Çikës ia laga/ buzën me nji tamël/ që ma prunë do gra/ Çika sytë i çeli/ ish hala e gjallë", f. 35. Këtu bie, jo perdja por loti i secilit!...

Poeti më aristokrat, Teki Dervishi, është po aq madhështor në vargje sa ishte në jetë: "Pse s'kanë lozur fëmijët - barin e njomë ta shkelin oborrit?/ Ata s'duan më të jenë lojtarë, por ushtarë të UÇK-së", f. 40. Teki Dervishi e kthen metaforën në urti, sidomos kur konstatohet se: "Nëse arrijnë të plaken, vdesin të njomë!". E në këta 20 vjet, jetojmë të plakur nga bëmat e tyre të njoma, pa të cilat nuk erdhi liria, kurse ne po "aktrojmë dhembjen", sidomos çjerretet me fjalë fyese

kundër luftëtarëve, po më tepër me lëvdatat e pakripa të atyre që sabotuan luftën, të cilët nuk prajnë për dashurinë që paskan për atdheun?! E sot pak, "kush beson se ka trima të gjallë?", në kohën kur disa mbllaçitën pa pra duke thurur ditirambe për "Heronjtë e gjallë?!" e, në anën tjetër, "ngushëllohem me fjalë të rrezikshme", përkatësisht të marrëzishme, pikërisht ashtu siç e thotë vetë poeti në poezinë "Dita e parë e verës '98", e cila ka një metaforë të rrallë, kumbuese, drithëruese dhe mjaft qortuese.














### DITA E PARË E VERËS '98

Po vijnë sharlatanët, politikanët, vëzhguesit, monitorët, humanitarë, mjekët pa kufij, zyrtarët e Bashkësisë Evropiane, rusët dhe kriminelët e tjerë. Nuk i la policia piktorët, kompozitorët, poetët, profetët – që të hyjnë në Banesën e Hanës shtatëvjeçare, ta pikturojnë duke qëndruar në këmbë pranë kufomave të prindërve të saj të masakruar. Teki Dervishi, f. 43

Për poezitë e Sh. Dibranit nuk është mirë të flasë vetë autori i tyre, përveçse mund të saktësohet se ato janë kronika, përkatësisht regjistrime të asaj kohe, të atyre dhembjeve personale, përkushtime familjare me metaforën që kanë fatalitetin e ngjashëm të motivi në poezinë e Sali Beqirajit. Ndërsa sipas poetit, Bislim Elshani, "Monstra te kufiri/ Na i merr targat e traktorëve/ letërnjoftimet, pasaportat, vizat/ për të na lënë pa identitet/ që të endemi si fantazma nëpër botë", f. 51. Motiv i trishtueshëm që mban vulën e asaj kohe, (prill 1999), dhe një parandjenjë që i paska prirë kobit fatkeq "të endjeve si fantazma nëpër botë".

## dritë mbi plagë

(sprovë për antologji)



Kosovë. Po me të njëjtën mjeshtri shprehet edhe në vargjet: "Kah Reçaku/ atë ditë rrugën e shmangu/ edhe vetë Zoti/ E nëse në Reçak të ka zbardhur drita/ Tregoji botës/ Sa i kushton shqiptarit liria", f. 57. Ngjashëm ka shkruar edhe poeti Naim Fetaj, në poezinë "Dosja pa numër", me vargje të trishtuara: "Prej fshati në fshat/ Me zorë nëpër këmbë/ Dhe t'vdekurit vinin pas/ Me shpirt ndër dhëmbë/ Mallkonin plakat/ Breg rruge sy si gaca/ Do të çetel qiella thoshin/ Po larg ishte Bllaca", f. 58. Për ta materializuar metaforën e kësaj gjëme e të këtij gjenocidi po përmendim vargjet e poezisë, "Portreti i një nëne", (që kërkon të birin e saj), ku do të prekë një plagë të hapur tash e njëzet vjet: "Ah ky vaj i saj/ Të therë... të pret... të vret/ Dushk e bar në mal... edhe kjo i thau/ E fushës dënësja i bie si një det/ Tash e njëzet vjet", f. 60, si dhe në poezinë "Tablo e vrarë", (në Strelc, 1999), poezi që ka një thirrje tjetër alegorike: "Pleqtë e mirë ku i ke... pa ta si e bërë natën/ Pa një këngë të re për Haki Pavatën/ E kur të t'i laj sytë e ta lidhi ballin/ Do ta bëjmë një këngë... do ta kallim defin/ Fol tash pak, o plak, me Adem Istrefin", f. 61.

Poetsha Diçe Demiri-Frangu merret me një plagë të rëndë, një plagë të pahapur sa duhet e si duhet, një plagë që rëndon sa vet jeta, sa vetë dhembja e një të dhunuare e cila rrëfen se "në trupin tim kam plot gropa të thella të zeza", ajo edhe pse vazhdimisht luftonte injorancën, mentalitetin patriarkal, duhej të ruhej: "Duke provuar t'mos i zgjoj kujtimet/ Se ende jam grua unë", poezia "E ende jam grua" ose "monologu i një të dhunuare", f. 62. Në poezinë "Sytë e vrarë të Dubravës në Majdanek", që mban datën, 23 maj 1999, ajo sjell dramën emocionale të refugjates duke shpërfaqur kataklizmin e asaj dhembjeje, atij gjenocidi shfarosës që kishte rënë si murtaja e zezë mbi Kosovën. Kampi Majdanek - Lublin në Poloni, është një frymëmarrje tjetër në këto poezi, një sfond përjetimesh plot gjenocid, përmes së cilës Diçe bën një krahasim të qëlluar në mes holokaustit hebraik në Luftën e Dytë Botërore dhe refugjatëve shqiptarë në Luftën e Kosovës '98/'99.

### KËPUCËT E MARIA BIELIEKËS

(Kampi Mjadanek-Lublin, 31. 05. 1999)

Në duar shtrëngoja këpucët e Zonjës Maria Bieliekës, pluhurin nacist duke ua fshirë Mendoja, diku maleve të Kosovës Jonës tamam do i binin, Ecja ajrit si somnabul Me këpucët e Maria Bieliekës mbathur Për t'ua kthyer në Kosovë Diçe Demiri - Frangu, f. 64 Dorën në zemër, nuk e kam



paramenduar kaq të çmendur poezinë e Dije Frangut, sepse atë e njihja lirike, por s'ka faj poetesha kur me sytë e saj ka parë "Mendte si i dilnin", një nënë në Bllacë, në të cilën ajo shprehet: "Unë ia pashë mendte si i dilnin/ Unë e pashë si për çast i humbën sytë/ Iu zbrazen nga bukuria/ Sa të lumtur jeni ju që nuk e keni parë/ Mendte si fluturojnë si humbin/ Zoti e bekoftë atë NËNË!", poezia "Unë ia pashë mendte si i dilnin", me përkushtimin "Një nënë në Bllacë, prill 1999", f. 65. Veçmas këto vargjet e fundit që i cituam, shprehin një tragjizëm unik, i papërsëritshëm, një poezi shumë e arrirë në planin estetik dhe tematik, por edhe kështu si është, edhe kështu si është kompozuar, ka rrezik që edhe lexuesi i vëmendshëm, të pësojë si ajo Nëna në Bllacë... Zot ruana!

Poezia e Eduard Frrokajt për motiv ka "Rrëfimin për një nanë", (ah këto Nënat tona?!), po me tragjiken e poezisë së Dije Frangut, vetëm në një pamje tjetër, pasi nëna në poezinë e Eduard Frrokajt, do ta djegë veten me benzinë: "Baladë për nanën Pashke Marku e cila tri ditë pasi ia sollën djemtë e vranë në Meje nga Batajnica u dogj me benzinë në kujtim të tyre", f. 66. Poezia si tërësi e bënë Eduard Frrokajn një poet, të veçantë po se po, por edhe për ta mbajtur mend gjithësesi, edhe nëse ai më nuk shkruan poezi të tjera. Poezia mund të kategorizohet e *detajit të thellë*, që prek zemrën e

dhembjes: "Kur i ndaluan Gjovalin dhe Milan Markun në fushë të Mejës/ nana iu lut dy herë zotit dhe kombit/ Çka i kanë ba kujt në këtë natë barbare djemtë e mi". Jo vetëm Pashke Markut, por në Meje të Gjakovës vrasësit edhe "Nanës Zoje Prendi ia vranë të pesë djemtë e ia lanë vetëm një kujtim". Ndërsa në "një ditë të bukur maji i kthyen ata me eshtra të bëra copë e grimë/ me e ruajt kufirin në Dukagjin/ Mbase një zanë ka thanë atë ditë/ a e dini o Gjovalin e Milan Marku/ sa herë asht lutë nana për me u kthye/ Nana tri ditë pas/ si në kryqëzim Krishti/ iku e u bë Rozafë/ me i muros kujtimet e atdheut/ Tha t'i bëjmë roje fisit/ Atdheut", f. 67. Tragjikja e kësaj poezie mbulohet vetëm me metafora poetike të kësaj natyre, në të cilat është përshkruar në mënyrë të saktë gjenocidi serb që ka ndodhur në fshatin Meje. Padyshim, nga një prizëm tjetër kjo poezi mbetet një kryqëzim i dalluar brenda kësaj "sprove për ta përshkruar tragjedinë".

Poeti Adem Gashi me mënyrën lirike prek plagën e luftës. Ai është poet i lirikave artistike mirë të realizuara, autor që ka regjistruar poetikën e vargut me të gjitha mënyrat e dhembjes, bashkë me pasthirrmat e gjëmave, ndodhi nëpër të cilat ka kaluar vetë poeti dhe shoqëria jonë. Së këndejmi, Adem Gashi, edhe temën (ndër më tragjiket, atë të dhunimit), e kthen në poezi duke lënë plagën të dhembë, plagë e cila deri vonë as

që është mëkuar, as që është treguar, e le më të jetë shkruar për "Dhimbjen që nuk ka emër", e cila është "Baladë për të Dhunuarat", kundrejt të të cilave, siç thotë poeti, "jemi kaq të verbër"?! Ndërsa klithma e tij, dhembshëm dhe trishtueshëm ndihet më mirë në poezinë "Arkivi i familjes sime", në të cilën i ka përshkruar shtatë klithmat, shtatë pasthirrmat, që me shkronjën "h", mund t'i ndërtojë vetëm poeti Adem Gashi! Një ekuilibër i veçantë lirik e poetik i ngjizur në tragjizëm. Duke shprehur metaforën e dhembjes poeti ka qitur në pah fytyrën ndryshe të barbarisë dhe gjenocidit serb në Kosovë. Ndërsa "Arkivi i familjes" është dokumenti më autentik që shpërfaq brohoritjet e dalldisura për lulëzimin e socializmit, periudhë për të cilën poeti poetikisht poetizon: "...kapitulli i socializmit/ s'kishte veçse gjoba mali fushe/ dëftesa të fryra tatimi/ dhe ftesa me tri vija të kuqe/ me vulë prej UDB-e", f. 69. Këtyre vargjeve ua shtojmë edhe diçka nga ato shtatë pasthirrmat e tjera poetike me të cilat ka regjistruar fundin e fatit fatkeq të fatiut njeri, shprehur po në atë poezi: "Lufta e fundit/ e zhbëri edhe kutinë e vogël prej druri/ tashti arkivi i familjes sime/ s'është veçse një kujtim i portretit të babait/ me shikim zhbirues ngjyrë tunxhi", f. 70.

Për Nexhat Halimin, "Dumnica fle përpëllitet udhës së kuçedrës" kurse "hëna mbi kullën e Gjergj


Elez Alisë", është lajtmotiv i poezisë "Shënime të ushtarit të UÇK-së", e shkruar "tek ura e Cenë Korjelit, në muajin maj '99", f. 72, mjaft mirë ka prezantuar një formë të dramës e të tragjikes së atyre viteve. Në anën tjetër, për poeteshën Teuta Haxhimusa-Çerkini, tragjedia në Burgun e Dubravës mbetet temë obsesive e këtij shtjellimi, madje në disa nuanca duket sikur vetë poetesha të ketë qenë pjesë e asaj tragjedie: "Ti ike, e unë mbeta, edhe pse bashkë ndamë fatin në Dubravë/ Ne dy bashkë ishim pengje në Dubravë/ Që atëherë, në buzëqeshjen time, mbaj dhe forcën tënde, vulë!", poezia "Në buzëqeshjen time", në fund të së cilës lexojmë edhe këtë shënim: "(Në shenjë kujtimi dhe nderimi për të gjithë të burgosurit-pengjet shqiptare të masakruara në burgun e Dubravës në maj 1999. Në veçanti, vargjet i dedikohen Besim M. Zymberit)", f. 73.

Ndër autorët që nuk kam lexuar kurrë më parë poezi, padyshim është Bedri Islami, për një çast, emri i tij ma ndali frymën, por frymëmarrjen ma ktheu poezia: "E shkruar më 29 mars 1999", vargje që fascinojnë, e shkurtër, përmbajtjesore, vlerë poetike me mesazhin e qartë që mund të kategorizohet dëshmi për gjenocid: "Në Kosovë/ të mbijetuarit/ po i futin në dhe për së gjalli/ të vdekurit/ për t'i rrvrarë/ po i nxjerrin nga varri...", f. 74.

Dan Kosumi ka bërë përpjekjen

e Sizifit, për jetën dhe për atdheun, i burgosur qysh në moshë të re, i përvuajtur edhe rrugëve të mërgimit, me brengën se dhe varri do t'i mbetet bosh. Vargje tragjike, shqetësuese, por si askush tjetër, poeti është krenar, ai qëndron në mënyrë stoike, ka zë kumbues, pamje burrërore dhe sy prej malësori. Padyshim është racë poeti, prandaj ëndërron një atdhe të mirë. Dan Kosumi është poeti që ndjenjën e shkrinë çdo ditë për atdhe: "Ah, Kosovë, mos ma rrëfe mëkatën tim/ S'të frymova dot të lirë, as dje, as sot.../ Eshtrat më dergjen larg teje, moj e Mirë.../ Varri im aty tek ti është bosh.../ Pa kokën time s'kam si kthehem tek ti...", poezia "Në kërkim të kokës sime", f. 76.

Poezitë e Milazim Krasniqit janë motive të trishtueshme, po aq të ngarkuara me figuracione e idioma të shumta. Rrëfime e përjetime dhe shprehje artistike të zburkuara me sajesa estetike, ku do të shprehin më qartë përjetimin real duke qartësuar edhe më mirë krimin e gjenocidin serb në Kosovë. Është vetë trishtimi tragjik dhe rrëfimi i tillë i paparë që ia shton edhe sot dhembjet Kosovës. Me një fjalë, poeti është mjeshër i rrëfimit. Ai di ku do ta fokusojë esencën e ngjarjes për ta materializuar qëllimin, me këtë mënyrë duket se poeti ka ndërtuar obelisk letrar për heronjtë e vargut dhe poezisë së tij. Me këto poezi tashmë edhe ata janë zëra dhe shpirtra të gjalla,



janë statuja që dëshmojnë për gjenocidin serb në Kosovë, tamam siç shprehet vetë poeti në shënime sqaruese nën poezi, që m'u dukën po aq letrare sa vetë poezitë:

UDHËTIMI I VJOLLCA BERISHËS, kushtuar një "Qytetareje nga Suhareka. E mbijetuar nga masakra e Suharekës e marsit 1999, ku u vranë pesëdhjetë civilë shqiptarë, shumica gra e fëmijë. Bashkë me të birin, Gramozin, dhe kumatën, Shyhreten, kërcyen nga kamioni që po bartte drejt Serbisë pesëdhjetë kufomat e asaj masakre. Atje autoritetet serbe i patën fshehur kufomat", f. 77-78.

KOKA E BANUSH KAMBERIT, "Fshatar nga fshati Reçak i Shtimes. Më 15 janar 1999 forcat policore serbe e vranë dhe pastaj ia prenë kokën. Kokën e prerë e morën me vete dhe ende nuk është gjetur", f. 79-80.

PLISI I SADIK SHERIFIT, "Fshatar nga Broja e Drenicës. Në masakrën e Izbicës, ku forcat militare serbe torturuan dhe masakruan 147 burra shqiptarë, civilë të paarmatosur, Sadiku mbeti i plagosur. Sipas dëshmitarëve, ai ka mbetur aty dyzet e tetë orë dhe ka vdekur nga hemorragjia e madhe", f. 81-82.

SYTË E ZOJE PRENDIT, "Nënë shqiptare nga fshati Korenicë i Gjakovës. Forcat terroriste serbe ia vranë të pesë djemtë (Sokolin, Vitorin, Markun, Robertin dhe Gjergjin), në fushatën e spastrimit etnik e gjenocidit serb në vitin 1999", f. 83.

Këto poezi, bashkë me përkushtimet, përbëjnë një mozaik tragjik me shtrirje gjeografike të cilën jo secili poet kaq artistikisht mund ta përthekojë. Në anën tjetër, motivi i shprehur në poezinë "Nata e 2 prillit", të Elirona Mahmutit, për "të vranët e natës së 2 prillit 1999 në Gjakovë", sjell një nuancë letrare më ndryshe, më të veçantë dhe, mbase, shumë e parandier: "At natë fqinjja na kish tregu që paska me ra shi/ E tha n'guhën e saj, që as sot s'e di/ Errësira erdhi, erdhën retë, shiu rigoj// Dielli doli por dritë nuk kishte/ Ditë e re pranvere duhej t'ishte/ rrugë çarshie shtruar n'martirë lirie", f. 86, duke shprehur tërë artin e dhembjes për tragjiken e krimin serb në Gjakovë.

Si duket, poetesha Miradije Maliqi do të rrojë përtej ikjes, për të dëshmuar në natën e gjykimit, një "Pritje e gurtë", pasi nën "atë copë qiell ku unë i drejtoj lutjet e mia/ e vdes përditë që të mbaj gjallë vetëm një çast, ah atë/ çast do t'i rinjoh sytë e përbindëshit, kur të vijë dita e/ ndëshkimit", f. 88.

Edhe poeti Arif Molliqi tragjiken e ka fiksuar në atë të diele pranvere kur "Askujt s'i bëhej vonë" dhe "ishte e diel pranvere// i nxorën në oborr motër e vëlla/ babai dhe nëna vdiqën/ nga zhurmë shurdhuese e armëve", pastaj "të

hënë pranverë e vonshme// vajza më e mirë e fshatit po hapte varrin/ bashkë me vëllanë e vranë/ t'i fuste shtatë palë n'tokë plagët e veta/ vitet e moshës së dhunuar/ ekstazën e vrasësve plot marrëzi/ në atë kohë/ askujt s'i bëhej vonë për vdekjen", kështu poeti e përmbyll tragjiken e atij gjenocidi me një dhembshuri sa tragjike po aq fisnike e cila materializohet shumë tragjikisht në rreshtat e fundit kur thotë se; "pak rëndësi ka nëse trupi i një gruaje/ ka mbetur mbi dhe/ që ta shohin së paku perënditë", f. 96.

Hajdin Morina shpreh një epigram të lirikës tragjike në Reçak, dhe krejt çka duhet thënë për poezinë e tij janë vetë vargjet të cilat gjakojnë për një të vërtetë si në poezinë: "Të jesh prej Reçakut", kur shkruan se: "Të jesh prej Reçakut/ ose vetë të jesh Reçak/ ndryshe të çelësh heshtja/ dhimbja e liria më 15 janar/ Ndryshe të mërdhinë/ e ndryshe të ndizet në shpirt/ dita e pushkatuar e 15 janarit/ nëse je fëmijë ose nënë e Reçakut/ Nëse ia pe sytë përmbi kodër/ 15 janarit pak para se të pushkatohej nga barbarët". Pastaj po në atë kohë, poeti bën një thirrje publike ndërgegjes së Evropës dhe të botës si dëshmitar i asaj kohe, i atij krimi dhe i atij gjenocidi, të cilin e paska parë me sy: "Në vendin tim/ Policët serbë/ Kanë vranë njerëz/ Fëmijë, zogj dhe pemë/ Policët serbë/ Kanë vranë rrezet e diellit/ Në tokë kur binin", f. 98.

Poeti Shqiptar Oseku ka ndërtuar një Obelisk me "99 Emra", duke lënë edhe këtë shënim: "Në Ditën Ndërkombëtare për Kujtim të Gjenocidit. Kushtuar masakrës së të intuarve shqiptarë në Burgun e Dubravës, 19-24 maj 1999, ku u vranë 99 njerëz duarthatë". Poezia e Shqiptar Osekut manifestohet nga një përshkrim autentik, thuaja se edhe vetë ishte pjesë e asaj tragjedie, asaj masakre, kundër të burgosurve shqiptarë me pranga në duar. Poeti motivin e kundron nga brenda vetë ngjarjes, kurse rrëfimi ka dalë më prekës dhe përjetimi bëhet më i trishtuar. Padyshim, është një dhembje që ta ndalë frymën, të gozhdon, të step, sidomos për prizmin kur prek motivin e dhembjes. Nuk e di nëse nga hartuesit e antologjisë paska qenë e planifikuar, apo për koincidence të rastit dhe fatit, këta "99 emra" edhe brenda këtij libri janë sistemuar në faqen 99. Ndoshta për të bërë më mirë "Dritë mbi plagë", metaforë kjo që i shkon secilës poezi për ta pasur në rreshtat e saj, por Shqiptar Oseku ka shkruar: "Së pari rrethuan ndërtesat me tanke e ushtri/ Ishim si ishull i frikësuar/ Pastaj braktisën korridorët brenda godinave/ për herë të parë qëkur qenë ndërtuar/ Por, ikja e tyre e beftë s'u duk kumt i mirë/ Zunë pikat e larta: hipën mbi pullaze e në pika mbi/ mure. Ishin

armatosur rëndë", f. 99. Gjatë poezisë ka ndaljeje të frymëmarrjes, sigurisht për ta përmblyllur këtë motiv kaq tragjik, ai ka rrefyer për veten dhe njerëzit e gjallë: "Nuk di të të them pse shpëtova?! Fshati im nuk është më/ Por, dua të të rrëfej si mbaruan shokët e mi/ Të lutem më dëgjo: së pari na rrethuan/ Ishim një ishull/ i frikësuar", f. 101, është shprehur tejet i trishtuar poeti Shqiptar Oseku. Ndërsa lirika e Mirela Papuçiut, me titull "Lulëkuqe në arat e Kosovës", përveçse bart metaforën e tragjikes, "Lulëkuqet në ara përdizën mbi kërcej", përkatësisht "si kujtesa në gjakun e Kosovës", f. 106, është edhe një copëz tjetër e atij mozaikut letrar në këtë libër antologjik

Poezitë e Ali Podrimjes shprehin shqetësim, andaj janë strukturuar si metamorfozë e dhembjes, dhembje kjo e cila e shoqëroi tërë jetën Ali Podrimjen. Poeti si askush tjetër dhembjen personale e transformoi në dhembje të përgjithshme, në shqetësim të përjetshëm, për vendin e tij që sa ishte i ri patë deklaruar se "Kosova është gjaku im që nuk falet". Kjo sinkroni e përcolli poetin deri në varë. Edhe në poezinë "Rënkimi", Ali Podrimja, mjaft i shqetësuar, shprehet: "Në flakën e oxhakut, t'oxhaqeve tona therë e pjekur/ kanë deshtë me këmborë, pragje thyer e konaqe mbyllur", f. 106. Por, siç e theksuam edhe më lart, gjithçka nga personalja, poeti Podrimja e ka shprehur edhe në poezinë "Përtej dhimbjes", në të cilën shihet se "Ka rënë degë e thyer prej reje në trupin tënd/ të shitur, Kosovë// Cila do të jetë kënga ime e mbramë/ dhe fjala e fisit tim/ Plepi i shtëpisë sime u dogj, ku t'i preh sytë/ ku ta shuaj flakën e ujtës për ty, Kosovë", f. 107, prandaj Ali Podrimja kishte ankth, tamam siç e shpreh edhe në poezinë "Ankthi", ku toka e poetit digjet, madje në çdo pëllëmbë të trupit të tij. "Toka ime e dashur/ balli im i ngrysur/ pishë...// Toka ime digjet/ në çdo pëllëmbë të trupit tim - toka e mallkuar...", f. 106 dhe vërtet Ali Podrimja shkoi atje ku nuk flitet më, me ankth në zemër me shqetësim në shpirt!

Se tema e të zhdururve është bërë obsesion për shumë poetë s'ka dyshim e, në anën tjetër, duket si temë e papërfunduar, përkatësisht plagë e hapur, këtë na e dëshmon edhe poezia: "Në të njëjtën ditë", e poetit Salajdin Salihu, ku shprehet: "Kishin moshë të ndryshme/ fëmijë/ të rritur/ pleq/ Të gjithë i vranë për një ditë/ të gjithë i gjetën për një ditë/ në një frigorifer diku në Danub", f. 115. Me këtë motiv përshkruhet edhe poezia e Halil Selimit, që ka një varg të shkurtër dhe mjaft konciz. Edhe ky poet për temë ka masakrën në Burgun e Dubravës, e cila ka ndodhur më 22-23 maj 1999, por në poezinë "Ferri i gjallë", e cila përbëhet

vetëm me dy vargje, janë thënë të gjitha, prandaj nuk duhet të zgjatet, pasi aty e thotë aq qartë atë që të tjerë nuk mund ta shprehin as me libra: "Zoti nuk ishte aty ato ditë/ Vdekja shëtiste e lirë", f. 118.

Drama e Kosovës, tragjedia e saj e ka shqetësuar edhe poetin Namik Selmani. Ai në poezinë "Pulëbardha e Kosovës", me përkushtimin: "Monologu i një vëllai kushtuar Fatmira Hasanit që në moshën 16 vjeçare u vra nga pushtuesit serbë në vitin 1998 në Likoshan të Drenicës (Kosovë)", e motërzën motivin e dhembjes dhe tragjikes në fisnikërimin e të vëllait i cili "Me krenarinë dhe dhimbjen që më jep kahmot motra ime Fatmira" f. 123, i jeton edhe rrugët e botës me mallin e Kosovës, dhe sigurisht edhe me mallin për varrin e motrës.

Po ashtu, edhe poeti Xhevahir Spahiu, i shkurtër në varg e i madh në mendime, më duket i paarrtshëm nga të tjerët në formimin e simbolikës eliptike, siç thamë, me pak fjalë artistike të realizuara mirë që shihet te poezia "Hyrje në tragjedi", në të cilën poeti shprehet se "Një kosë vringëllon mbi Kosovë/ Tehu i kosës sajton nëpër ajër/ fjalën paqësore masakër/ Pas gostisë së përgjakshme vjen paqja?/ Në tragjedi le të hyhet pa maska", f. 124.


Ngjashëm me poetin Xhevahir Spahiu ka vepruar edhe poeti Ismail Syla, i cili e kultivon me pasion poezinë me simbolikë të qartë dhe mesazh përmbajtësor. Te poezia "Rënkimi dhe dënësja e gjallë", ka prekur plagët: "Sot preka e më preku dënësja shqiptare/ Si të ishte një qenie krejtësisht e

gjallë/ Si para njëzet vjetëve dhe një më shumë/ Në Abri, Reçak, Krushë, Izbicë, Rezallë", Krushë e Vogël, 26 mars 2019, f. 127.

Poeti Isuf Sherifi, tërë dramën e Kosovës, tragjedinë e saj, tërë krimin dhe barbarinë serbe, gjer në shkallë gjenocidi ka arritur ta përmbledhë në dy-tre poezitë e prezantuara në këtë "sprovë për antologji", qoftë poezia "Djegia e gjelbërimit", një lirikë e realizuar me tërë tragjiken përbrenda saj ose poezia, "Maçkatica", që është një gjetje e faktit psikologjik për të regjistruar një formë ndryshe të asaj që kategorizohet si gjenocid, mbi një popullsi të pafajshme dhe kryesisht të pambrojtur, andaj: "Së pari ua prenë gjuhën/ Që të mos mund t'i pështynin në surrate/ Pastaj ua shkullën sytë/ që të mos mund t'i shihnin/ duke ua nxjerrë zemrat/ Në fund/ fëmijë, gra dhe burra/ i hodhën në furra" e për ta konkretizuar, përkatësisht për ta qartësuar efektin poetik, Isuf Sherifi, ka futur edhe një tekst shpjegues ku thuhet: "Djegia e trupave në fabrikën "Maçkatica" është bërë në dy etapa, më 16 dhe 24 maj të vitit 1999, pas mesnatës, nën mbikëqyrjen e "Beretave të kuqe", të cilat atëbotë e kishin bazën e tyre në "Bella Vodë" - afër Vranjës në Serbi. Komandanti i atëhershëm i "Beretave të kuqe", Millorad Legija, sipas burimeve në fjalë, kishte marrë pjesë personalisht në përcjelljen e një transporti deri në vendin e ngjarjes dhe kishte qenë i pranishëm gjatë djegies së tyre. Trupat qenë djegur në "shkritoret e hapura" nr. 4 dhe 5", (Kandiq: Mackatica, i forni crematori), f. 133. Ndërsa në poezinë "Shënim i Ana Frankut

## dritë mbi plagë

(sprovë për antologji)



postmortem”, përmes metaforës së Ditarit të famshëm të Ana Frank, Isuf Sherifi e kthen atë libër të famshëm në funksion të ditarit poetik, në vitin 1999 ku, mes të tjerash, paska shënuar: “1999. Panterat e kuqe/ pjekin pëllumba të bardhë/ Ana mblodhi përsëri eshtrat në varr/ Në ditar shtoi edhe një varg:/ Maçkatica, 16 dhe 24 maj”, f. 134.

Ngjashëm me Isuf Sherifin ka vepruar edhe poeti Lulzim Tafa, i cili qysh në titull shpjegon se është “Atmosferë luftime”, kurse “Në Kosovë atë ditë/ U shtrenjtua buka/ Vaji/ Mielli/ Sall jetës i ra/ Çmimi/ Vdekje/ Kishte me bollëk”, 1998, f. 136. Tamam artistikisht e përcakton se, mbase, çdo gjë në kohë luftime shtrenjtohej, përveç “çmimit të vdekjes”, i cili, siç shprehet ai, ishte me bollëk. Po ashtu, Lulzim Tafa, me një poezi tjetër mjaft mirë të realizuar paska bërë “Raport nga Kosova 1999”, ndërsa në atë raport paska konstatuar se: “Këtu nuk shkelen të drejtat/ Dhe liritë e njeriut/ Këtu shkelen vetëm kokat”, f. 138. Edhe pse poezi është me vetëm tri vargje, Lulzim Tafa, ka arritur të nxjerrë një tragjikë të madhe.

Agim Vinca është një poet lirik i realizuar, në sfondin e poezisë shqipe. Ai është mjeshtër i vargut, i mendimit dhe metaforës. Pra, mjeshtër i vargut estetik, i metaforës eliptike dhe i rimës së përsosur mbresëlënëse që së bashku përcjellin mesazhin më të artikuluar të kësaj drite eliptike, përkatësisht të kësaj metafore si dhembje, si plagë e hapur në Kosovë. Tamam siç shprehet vetë poeti në poezinë: “Monolog i të rënëve në Reçak”, një dramë më vete, nga e cila mësoi bota se në Kosovë pushtuesi serb po ushtron gjenocid dhe pastrim etnik. Po më mirë t’iu referohemi vargjeve të poetit, pasi ai e thotë më së miri: “Atë që pamë në cikmën e janarit/ Do t’ia rrëfejme natës së varrit”, ndërsa heronjtë tragjik flasin se: “Ne ramë si gruri nga dorë e xhelatit/ Në këto gërxhe e skërka të Ballkanit// Përse na ratë, përse na vratë/ Kokën nga trupi përse na e ndatë?// Pasi na korrrët si deshët vetë/ Përse na endni poshtë e përpjetë// Na lini të qetë, të grirë, të flakur/ Dhe - mos e harroni përrallën e përgjakur”, (Pristinë, janar-shkurt 1999), f. 142. Po këtë tragjikë, po të njëjtat krime i gjejmë edhe në poezitë e Mustafë Xhemajlit. Sidomos “Në brigjet e Drinit të Bardhë”, përmes së cilës pasqyrohet formën e gjenocidit serb që kanë bërë mbi popullatën e pafajshme, duke nxjerr vargje veç gjak, veç dëneseje kur, “e tërhoqën zvarrë nëpër pragun e shtëpisë/ Deri te mesi i oborrit e dërguan plakun Nikë/ Ia dhanë një shpullë e ai u skuq u skuq u skuq”, f. 143, ose në strofën tjetër të kësaj poezie në të cilën: “Foshnjën Lehonën Bardhin dhe plakun Nikë/ Gjelin pa kokë e futën në trastë ushtarake/ Aty ku e kishin

shlivovicën. Kapiteni klithi: Napred!/ Deri te brigjet e Drinit të Bardhë deri te mali me lisa/ I vranë oh në mëngjes i vranë pa krisma pa krisma!”, f. 144.

Poetët Uran Krasniqi dhe Muhamet Mavraj për temë kanë fituesin e Çmimit Nobel në Letërsi, austriakun Peter Handke, një filoserb dhe një shkrimtar i cili haptas ka dalë në mbrojtje të xhelatit duke shkelur mbi viktimat. Ky qëndrim i tij ndaj luftërave në ish-Jugosllavi, ndikoi në pezmin publik i cili u shfaq edhe përtej Kosovës, kudo te shkrimtarët humanë dhe progresistë. Brenda librit janë përfshirë tri poezi, njëra e Uran Krasniqit dhe dy të Muhamet Mavrajt, duke krijuar edhe një temë tjetër brenda kësaj sprove, që i përket gjenocidit serb në Kosovë. Pra, Uran Krasniqi, “Kartolinë urimi Peter Handkes” ose Muhamet Mavraj, me poezitë “Panairi i pafuqisë”, me shënimin: “Prekazi, Srebrenica, Reçaku, Alepo...: një kopje për Akademinë Suedeze. Nga Prishtina, më 10 dhjetor 2019”, si dhe poezia tjetër “Drejtësia s’ka fotografi”, e shkruar më 15. 12. 2019, kanë bërë mozaikun më të saktë të këtij veprimi kulturor. Në nuanca të këtij zhargoni mund të kategorizohet edhe poezia e Dije Lohajt me titull “Një ditë”, që i drejtohet një vizitori në Kosovë, (qoftë Handke apo emisarëve serbë), që para se të vijë në këtë vend të mbuluar me plagë e varre, fillimisht t’i vizitojnë vendet, fshatrat, lokalitetet, ku është ushtruar gjenocid serb në Kosovë.

Ag Apolloni, Berat Dakaj, Muhamet Mavraj i kanë harruar lirikat, pasi poezitë e tyre janë të zhytura nga mendime të rënduara me figuracione të shumta, të zymta, përplot dhembje e halucinacione nga krimi dhe barbaria që ka ndodhur mbi subjektin që ata trajtojnë. Aq të zymta janë poezitë e tyre sa para syve të lexuesit rikthehen duke u shfaqur skema të luftës, tymnajë luftime, rrëke gjaku dhe fishkëllima të predhave artilerie, të cilat së bashku kompletojnë mozaikun e motiveve letrare në këtë *sprovë për antologji*.

### Motive të mbytura në pellgje gjaku


Nuk patëm mundësi t’i shihnim poezitë nga një këndvështrim tjetër për t’i klasifikuar sipas kontekstit kohor, për t’i vërejtur motivet dhe emocionet të cilat janë të rastit e të çastit të skemës së luftës, e të cilat janë sajesa estetike dhe letrare të mëpastajshme sa për ta plotësuar autorët mozaikun e poezive me këtë tematikë. Nëse motiveve iu bëjmë qasje kritike nga ky prizëm, do të vërejmë se këto dy tipa poezish do të ngjasojnë me një copëz magnetik ku njëra refuzon ndjenjën për ta përfaquar artistiken, poli tjetër synon me tërë ndjenjën ta përshkruajë dhembjen

e përjetuar në mënyrë autentike. Padyshim, poezitë për gjenocidin, të shkruara nga distanca, kanë përfaquar më shumë mënyrën lirike të rrëfimit artistik, duke iu shmangur dukshëm momentit emocional të të rrëfyerit. Me një fjalë, këto poezi kanë përshkruar më mirë dhembjen artistike, të parat qëndrojnë më mirë në aspektin heroik.

Poezitë janë krijime letrare sa të zymta po aq shprehin revoltën e autorëve për dramën e tyre të përjetuar, qoftë në aspektin emocional e qoftë si përjetime në rrafshin real, sidomos për ato a ata të cilët luftën e kanë përjetuar në betejë, duke e sfiduar jetën e tyre dhe të bashkëluftëtarëve. Poezitë e tilla janë më të zymta, më tragjike dhe më të përjetuara. Natyrisht në këtë rrafsh futen edhe përkushtimet e tjera të kësaj natyre që kanë të bëjnë me të afërmit dhe bashkëluftëtarët ku do të shprehin një afri njerëzore për dramën e përjetuar të luftës dhe për ta kuptuar ma mirë edhe çmimin e lirisë mbi të cilën është ndërtuar e tashmja e dhembshme e Kosovës, bile bashkë me vrasjet dhe grirjet, si dhe ekzekutimet, dhunimet dhe poshtërimet e shumta. Kurse në anën tjetër me dëmet e shumta materiale, me djegien e shtëpive dhe të pasurisë, dëbimet masive e deri te zhdukja e kufomave dhe të dokumenteve për identitet, përmes poezive janë përshkruar saktë tragjedite dhe gjenocidi, e nëse antologjinë e paraqesim në versionin “3D”, do të shohim se poeteshat dhe poetët shprehin edhe revoltë të vrazhdët nga e cila nxirren në pah format e dhunës serbe mbi shqiptarët dhe Kosovën në përgjithësi.

Kjo sprovë për antologji u quajt edhe “homazh për të rënë dhe lirinë e Kosovës”, libër ky që i ka munguar skenës letrare shqiptare pasi, siç theksojnë edhe njohësit e kësaj fushe, poezi dhe libra me përmbajtje të tillë janë shkruar dhe botuar edhe më parë, por të përmbledhura brenda një libri të kësaj natyre dhe me tematikë për gjenocidin serb, deri më tash nuk e kemi pasur, prandaj “sprova për antologji”, merr vlerë edhe më të veçantë.

Në këtë prizëm poezitë paraqesin përjetimet e autoreve dhe të autorëve për vuajtjet e tyre shpirtërore, ndonjëri edhe fizike, dhembjet për të afërmit dhe të dashurit, në vargjet e të cilëve lexuesi përjeton tmerre dhe njëkohësisht sheh pellgje gjaku, sheh lot rrëke, mbi shpirtin poetik, mbi përjetimet e tyre emocionale dhe artistike, pa të cilën në mënyrë artistike nuk ishte përshkruar gjenocidi serb në Kosovë. Dhembja artistike artikulohej më mirë, kurse dhembja faktike jeton më gjatë. Pra, edhe poezitë në këtë antologji janë krijime që shprehin çaste delikate, andaj në shumicën prej tyre nuk ka mundur të ketë shprehje më të mira dhe lirika më



të realizuara, por si dhembje dhe si libër do të jetojë gjatë.

### Arti dhe poezia

Arti dhe poezia janë një shteg i mirë për në përjetësi. Librat janë një pushimore në arkiva dhe biblioteka, qofshin shtëpiake e qofshin ato ku ruhet dhe sistemohet libri, i cili kurdoherë mbështjell plagët dhe dhembjet e viktimave nëpër gjenocide. Me një fjalë, janë klithma të heshtura në pikë të territ, janë memece në pikë të ditës, poezitë janë një fashë mbi plagë, si loti mbi dhembjen.

Me një fjalë, “Dritë mbi plagë” është thirrje universale për të mos harruar, për ta shprehur humanizmin dhe përkrahjen e mijëra grave të përdhunuar, e mijëra viktimave që i kanë humbur të dashurit. “Dritë mbi plagë”, është thirrje për t’u solidarizuar me invalidët e luftës, është apel për t’i socializuar në zemrat dhe në mesin tonë të gjitha viktimat e luftës që kanë humbur gjymtyrët ose që kanë pësuar trauma psikike e përdhunime të shumta. Me një fjalë, kjo “Dritë mbi plagë”, është loti me kripë mbi plagën e hapur që të detyron të reagos, prandaj shoqëria jonë nuk guxon të harrojë as këtë plagë dhe as të tjerat, por duhet të reagojë e zemëruar.

Shoqëria jonë kurrsesi nuk duhet ta harrojë këtë tmerr dhe këtë gjenocid me përmasa etnocidi që na obligon secilin dhe secilën, që në formë të dokumentuar, në rrugë juridike, ose me angazhime artistike, muzikore dhe letrare, ta prezantojmë artistikisht gjenocidin serb në Kosovë, në mënyrë kulturore këtë veprim ta shpallim si denoncim para botës, përpara qytetërimeve. Vetëm kështu dhe me këto forma, si popull dhe shoqëri bëhemi më njerëzorë, më të ndërgjegjshëm dhe shumë më të përgjegjshëm për atë që ka ndodhur, për të tashmen që po ndodh, dhe për të ardhmen që sigurisht do të ndodhë.

### Mesazhi lirik si “dritë mbi plagë”

Padyshim, “Dritë mbi plagë” ka përshkruar vuajtje e dhembje, plagë e varre, uri të shumta, dëneseje deri në zenit, kurse vargjet janë përplot lot e gjak. “Dritë mbi plagë” është një libër i cili e

sprovon me sukses “sprovën”, por nuk pretendon se e ka shterur mundësinë për të përzgjedhur dhe për të botuar edhe libra të tjerë të kësaj natyre.

“Dritë mbi plagë”, ose “sprovë për antologji”, hap debat kulturor, akademik edhe të nivelit universitar. Jo garë për të bërë libër të kësaj natyre edhe më të realizuar, sepse kjo është e mundshme, bile pa i përdorur këta autorë dhe poezitë e tyre, me një fjalë është hapur ideja për qasje akademike dhe studimore, që bie në kompetencë të institucioneve shkollore dhe universitare, për të studiuar ose mbrojtur tema akademike pikërisht nga kjo fushë, për ta qartësuar edhe më mirë dhe më profesionalisht dhunën dhe gjenocidin serb. Nga kjo sprovë shihet se temat janë të shumta, mënyrat e qasjes edhe më tej, prandaj seleksionimi dhe tematizimi është proces i cili duhet të hulumtohet, studiohet dhe të zhvillohet.

Siç e kemi theksuar edhe më parë, tema e dhunës serbe, tema e krimin serb, gjenocidi i paparë, pastaj për gratë e dhunuara, masakra mbi të burgosurit në burgun e Dubravës, refugjatët, si dhe mënyrat e shkrimit letrar, përkatësisht poezitë e shkruara në kontestin kohor të ngjarjeve dhe poezitë artistike që ngjarjes i qasen nga perspektiva aktive, si dhe motivet e tjera të shumta e të ndryshme të cilat nuk i përmendëm ose na janë përvjedhur pa i hetuar fare, duhet të studiohen dhe si mendim të ngrehen në nivelin akademik. Me një fjalë, është detyrë e profesorëve universitarë për të hartuar programe dhe për të hulumtuar tema me motive të tilla, sepse poezitë brenda këtij libri janë përplot ide dhe me motive të shumta të cilat mund të zërthehen e trajtohen vetëm nga studiuesit e kësaj fushe, qoftë vetëm sa për të fituar grada universitare dhe tituj akademikë. Gjithsesi, gjenocidi duhet të pasqyrohet edhe përmes studimeve në fusha të tjera, pasi dhuna dhe gjenocidi serb në Kosovë ishte me përmasa shkatërruese, andaj nuk duhet të harrohen.

(Marrë nga revista “Akademia”, nr. 8)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Kosova 'harron' dështimin ndaj Moldavisë, përgatitet për ndeshjen me Greqinë

"Dardanët" e kanë "harruar" shpejt barazimin ndaj Moldavisë (1-1). Ata i kanë filluar përgatitjet për ndeshjen me Greqinë që do të zhvillohet të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri". Pas konfirmimit të gjashtë mungesave për ndeshjen e dytë në Ligën e Kombeve, Bernard Challandes ka ftuar dy futbollistë, Rron Brojën dhe Armend Thaqin



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë në ndeshjen kundër Moldavisë, e cila është zhvilluar të enjten në Itali në kuadër të edicionit të ri në Ligën e Kombeve. "Dardanët" e kanë "harruar" këtë dështim dhe kanë filluar përgatitjet për ndeshjen e radhës kundër Greqisë, e cila zhvillohet të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri". Futbollistët e Kosovës të premtën kanë kryer testet për Covid-19 dhe pasdite kanë zhvilluar përgatitjet në stadiumin "Rexhp Rexhepi" në Drenas. Lajmi i mirë për Kosovën para ndeshjes ndaj grekëve është se mungojnë gjashtë futbollistë: Milot Rashica, Benjamin Kololli, Leart Paçarada, Elbasan Rashani, Hekuran Kryeziu dhe Herolind Shala. Trajneri Bernard Challandes ka reaguar menjëherë dhe ka ftuar në përfaqësues Rron Brojën e Partizanit dhe Armend

Thaqin e Ballkanit. "Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, ka ftuar edhe dy futbollistë: Rron Brojën nga KF Partizani dhe Armend Thaqin nga FC Ballkani, të cilët tashmë i janë bashkuar ekipit në 'Hotel Emerald', pasi për ndeshjen kundër Greqisë do të mungojnë Milot Rashica, Benjamin Kololli, Leart Paçarada, Elbasan Rashani, Hekuran Kryeziu dhe Herolind Shala", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Pas ndeshjes ndaj Moldavisë, Bernard Challandes ka folur edhe për përballjen ndaj Greqisë ku ka thënë se, pavarësisht barazimit, Kosova do të japë më të mirën në ndeshjen e radhës në Prishtinë. "Ne jemi Kosova. Unë kam besim te kjo skuadër. Nuk ishte ndeshje e keqe. Nuk ishte rezultat i keq. Nuk është problem për mua. Nuk ishte ndeshje e lehtë. Do të qëndroj i qetë me skuadrën dhe ne do të punojmë dhe do ta japim më të mirën ndaj Greqisë", ka thënë Challandes.

**Golashënuesi i Moldavisë ndaj Kosovës rezulton me Covid-19, pritet vendimi i UEFA-s**

Golashënuesi i Moldavisë në takimin ndaj Kosovës, Ion Nicolaescu, ka rezultuar pozitiv në testin e koronavirusit të bërë pas ndeshjes. Lajmi është konfirmuar nga kryetari i FFK-së, Agim Ademi, i cili në një prononcim për "Telegrafin" ka thënë se janë në pritje të vendimit nga UEFA. "Sapo na erdhi informacioni nga UEFA se sulmuesi i Moldavisë, i cili ka shënuar gol, ka rezultuar pozitiv me Covid-19 në testin e bërë pas ndeshjes", ka thënë fillimisht Ademi. "Vlen të ceket se ai para ndeshjes e ka pasur testin negativ dhe atë dëshmi e ka lojtari dhe UEFA. Tani jemi në kontakt me UEFA-n dhe vendimi i epilogut të ndeshjes i takon atyre", ka theksuar Ademi. "Jemi duke jetuar në një gjendje të jashtëzakonshme dhe nuk kemi informata të shumta rreth kësaj çështje. Ne do ta pranojmë dhe respektojmë çdo vendim të UEFA-s", përfundoi i pari i FFK-së.

SHKURT

## Dijoni e dëshiron Celinën

Bersant Celina është afër marrëveshjes për transferim në skuadrën franceze Dijon. "BBC Sport Wales" raporton se klubi francez ka shfaqur interesim për reprezentuesin e Kosovës. Ish-anëtarë i Manchester Cityt me Swansea ka regjistruar 79 paraqitje, teksa shpeshherë ka qenë vendimtar me gola.

## Inzaghi tregon se Lazio është gati për transferimin e Muriqit

Sulmuesi Vedat Muriqi është lidhur që një kohë të gjatë me një kalim në skuadrën e Lazios nga Fenerbahçe. Edhe pse është thënë që marrëveshja ka përfunduar, zyrtarizimi ende nuk ka ndodhur, por kjo mund të ndodhë pas ndeshjeve të kombëtareve. Kështu, së paku, ka bërë me dije trajneri i Lazios, Philippe Inzaghi, ku ka folur për Muriqin dhe transferimin e Fares. "Ne jemi duke folur me ekipet respektive dhe po ua bëjmë dije atyre, se 'ne do të jemi gati'", ka thënë Inzaghi. Kujtojmë se Lazio i ka dy objektiva. Fares është lojtar i SPAL, kurse Vedat Muriqi luan për ekipin turk të Fenerbahçes.

## Low: Për Mullerin s'ka vend te Gjermania

Trajneri Joachim Low ka thënë se Thomas Mulleri është një lojtar shumë i mirë, por që nuk ka vend në Kombëtaren e Gjermanisë. "Ai është një lojtar i madh, por me Gnabry, Haverzin, Brandin dhe Sanenë është e vështirë të gjej një vend për të", ka thënë Low.

## Përforcohet KB Ponte Prizreni

Klubi i Basketbollit "Ponte - Prizreni" ka zyrtarizuar përforcimin e parë të huaj. Bëhet fjalë për Ty Nicholas i cili ka qenë edhe vitin e kaluar pjesë e klubit nga Prizreni. "Të dashur adhurues të basketbollit, në vllugun më të madh të para përgatitjeve për edicionin 2020/21 kemi kënaqësinë dhe entuziazmin ta prezantojmë përforcimin tonë të parë të huaj i cili vitin që shkoi dëshmoi performancë brilante duke u vlerësuar si një ndër fundorët më të mirë në ligë me mesatare prej 21 pikëve, 5 kërcimeve, 5 asistime dhe 2 topa të rrëmbyer. Ky është Ty Nichols", thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

## Thaqi, pas prezantimit të Ballkanit: Faleminderit Prishtinë!

**SUHAREKË, 4 SHTATOR** - Skuadra e Ballkanit e ka prezantuar të enjten në mbrëmje njërin nga transferimet më të mëdha në këtë afat kalimtar, Armend Thaqin. "E kemi paralaj-

jmëruar para disa ditësh, sot zyrtarizuar bashkëpunimin me anësin Armend Thaqi për dy vjet të ardhshëm. Na priftë e mbara super Thaqi!", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Ndërsa Thaqi e ka falënderuar skuadrën e Prishtinës dhe tifozët "Plisat". Ish-kapiteni i kryeqytetasve ka shprehur optimizëm se do t'i arrijë objektivat me klubin e ri. "Faleminderit Prishtinë,

faleminderit FC Prishtina, faleminderit 'Plisa! Për dy vjetët e ardhshëm do të jam pjesë e FC Ballkanit. Me ndihmën e Zotit dhe me punë shpresojmë që t'i arrijmë synimet e klubit", ka thënë Thaqi.



## Spaqi la futbollin për basketboll: Simonsi ishte kundërshtari më i vështirë

**PRISHTINË, 4 SHTATOR** - Një nga basketbollistët më të dalluar në Kosovë pasluftës është Valentin Spaqi. Basketbollisti i cili ka luajtur për Bashkimin, Sigal Prishtinën e Mabetexin ka fituar disa trofe në basketbollin e Kosovës dhe ka qenë një lojtar shumë i respektuar nga tifozët. Spaqi, tashmë trajner, në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së ka treguar si filloi me basketboll, ndeshjen e paharrueshme, kundërshtarin më të vështirë dhe mesazhin për lojtarët e rinj. "Vendimi për të luajtur basketboll ka qenë në vitin 1994 kur babai im më tha se ka ardhur një trajner nga Italia në Prizren. Duke parë gjatësinë time më tha shko stërvitu tek ai trajner. Tashmë ai trajner ka ndërruar jetë. Nga futboli u kyça në basketboll, ku pa trajnerin Dërvish Agaj, unë vështirë se do t'ia kisha dalë të arrija këto rezultate në basketboll. Në atë kohë isha 14 vjeç e gjysmë", ka thënë Spaqi, i cili ka treguar edhe për idhullin e tij në fëmijëri. "Idhulli im në fëmijëri ka qenë Toni Kukoc, lojtari me numër 7. Ky numër më është lidhur edhe me numrin e fanellës që kisha në futboll", ka shtuar ai. Sa iu përket



trofeve të fituara gjatë karrierës si basketbollist, Spaqi nuk e ka specifikuar ndonjërin si më të rëndësishmin. "Të gjithë trofetë janë një kujtim i mirë dhe kam shumë kujtime të mira nga trofetë. Nuk mund të veçoj ndonjë, por jam i lumtur për trofetë që kam fituar", ka deklaruar Spaqi. I pyetur se cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë, Spaqi është përgjigjur: "Ndeshjen që nuk do të harroj

asnjëherë është ajo në Mitrovicë me Sigal Prishtinën kundër Trepçës. Ka qenë finalja e Kupës". Ish-basketbollisti i njohur, Valentin Spaqi, e ka vlerësuar Hashim Simonsin si kundërshtarin më të vështirë. Spaqi në fund ka dhënë edhe një mesazh për basketbollistët e rinj: "Mesazhi im është të stërviteni sepse tani i keni të gjitha kushtet. Jam në dispozicion t'i ndihmoj në çdo kohë basketbollistët e rinj".

## Toronto në sekondën e fundit e mposhti Bostonin

**ORLANDO, 4 SHTATOR** - Një gjuajtje e saktë nga distanca në sekondën e fundit nga ana e Anunoby (12 pikë e 10 rebounde) i dha fitoren skuadrës së Torontos, që mundi 104-103 Bostonin, duke rihapur garën për në finale të Konferencës së Lindjes. Skuadra e Celticsit po shijonte fitoren, por ndodhi surpriza në sekondën e fundit, me kanadezët që fitojnë gjysmëfinalen e tretë (Bostoni



udhëhoqi 2-1 me ndeshje). Lowry me 31 pikë e Van Vleet me 25 pikë ishin dy shënuesit më të mirë të ekipit kanadez, kampion në fuqi në NBA. Për Bostonin u dallua Walker me 29 pikë, por që mbetën për statistikë. Në Perëndim nisin

ndeshjet e para gjysmëfinale, me Clippersat që fitojnë 120-97 ndaj Denverit. Sfidë e komanduar nga skuadra e Clippersit, që në pjesën e dytë u shkëput falë 29 pikëve të Leonardit, më i miri në fushë. Te Denveri mungoi lojtari lider.

### SHKURT

#### Xhemajli përforcon Sunderlandin

Skuadra e njohur angleze Sunderland ka zyrtarizuar transferimin e Arbenit Xhemajlit. Lajmi është dhënë nga skuadra e Sunderlandit në faqen zyrtare të klubit. "Sunderlandi është i kënaqur të njoftojë për nënshkrimin e mbrojtësit të Kosovës, Arbenit Xhemajli", thuhet në njoftim. 22-vjeçari ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me Sunderlandin.

#### Babai i Messit, La Ligas: Nuk ka klauzolë në kontratën e Leos

Zhvillime dramatike në Spanjë rreth të ardhmes së Lionel Messit. Babai i Lionel Messit i ka dërguar një letër si përgjigje La Ligas, rreth klauzolës së të birit të tij. La Liga ditë më parë përmes një komunikate bëri me dije se në kontratën e Messit ekziston një klauzolë, e cila mendohej të jetë 700 milionë euro për largimin e tij. Por, babai i Messit përmes një letre i është përgjigjur La Ligas, me fakte të ofruara, se ajo klauzolë nuk është në fuqi më. Babai i Messit, Jorge, ka hedhur poshtë pretendimet se klauzola e Messit është ende e zbatueshme. Jorge insiston se kjo klauzolë nuk është e zbatueshme që nga sezoni i kaluar dhe Messi mund të largohet nga Barcelona.

#### Gjashtë lojtarë të PSG-së infektohen me Covid-19

Infektive në masë me koronavirus te skuadra kampione e Francës, PSG. Pasi rezultuan pozitiv futbollistët si Neymar, Angel Di Maria dhe Leandro Paredes, edhe tre lojtarë të tjerë janë konfirmuar me Covid-19 pas testeve të kryera në funksion të nisjes së sezonit të ri. Sipas prestigjiozes "L'Equipe", ata janë Mauro Icardi, Marquinhos dhe Keylor Navas. Numri i rasteve në klubin parisien rritet në gjashtë, çka ka vënë në alarm drejtuesit, pasi do t'u duhet ta monitorojnë situatën me shumë kujdes për të mos rrezikuar fillimin e sezonit. Të gjithë futbollistët pozitivë janë izoluar në banesat e tyre.

#### Sanchezi: Doja kthimin tek Arsenali pas ditës së parë në 'Old Trafford'

Sulmuesi i Interit, Alexis Sanchez, është rikthyer të flasë për periudhën e vështirë që kaloi te Manchester Unitedi. Kiliani tashmë është zyrtarisht një lojtar i Interit pasi u transferua me parametra zero nga "Djajtë e Kuq". Sanchezi, gjithashtu, zbulon se në 2018-n ka qenë shumë pranë një kalimi te Manchester City, por rivalët e qytetit u treguan shpejt në transferimin e tij. "Më 2018 kisha një marrëveshje me Cityn, por për disa arsye të ndryshme marrëveshja u arrit me Unitedin. Më kujtohet stërvitja e parë me Manchesterin dhe shumë gjëra më vijnë në mendje. Sapo mbarova seancën stërvitore shkova në shtëpi dhe e pyeta agentin dhe familjen time nëse mund të kthehesha tek Arsenali", ka deklaruar 31-vjeçari për "Peleteros TV". "Diçka nuk shkonte te Manchesteri. Kaloi një muaj dhe ishte po e njëjta ndjenjë që kisha ditën e parë. Ne në atë çast nuk ishim një familje dhe kjo u reflektua në fushë. Ata më fajësonin vetëm mua, edhe pse unë luaja vetëm për pak minuta. Ne nuk ishim një grup, por në fund duhej ta merrja unë të gjithë fajin", ka shtuar Sanchezi.

#### KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Miami (0-2)  
Boston - Toronto 103-104 (2-1)

#### KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Clippers - Denver 120-97 (1-0)  
Lakers - Houston



**MITROVICA**  
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

**D P A**

Departamenti për punë administrative

Mitrovicë / Nr.

Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.07/2019 për strukturën, përmbajtjen dhe dorëzimin e raporteve financiare vjetore, me datën 04.09.2020 mori vendim për të shpallë:

## KONKURS

### I. (1) Menaxher për Financa dhe Kontabilitet

#### Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës:

- kordinimi i punëve të dokumentacionit financiar të të tri njësive (Mitrovicë, Vushtri, Skenderaj),
- pranimi i dokumentacionit dhe shikimi i rregullsisë së tij,
- regjistrimi i tërë dokumentacionit në librat e kontabilitetit,
- regjistrimi i ekstrakteve bankare në librat e kontabilitetit nga bankat ku kompania ka llogarit e hapura si dhe barazimi i tyre me librat e kontabilitetit,
- pranimi i faturave hyrëse, regjistrimi i tyre në kontot adekuate nëpër njësit përkatëse,
- pranimi i fatyrave dalëse si ato të shërbimeve, të ujit, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit,
- përcjellja e arkës për njisi, arkat e inkasimit ditore dhe arkën e shpenzimeve,
- për secilën njisi arkat e të hyrave dhe shpenzimeve, regjistrimi i tyre në librat e kontabilitetit, barazimi i inkasimeve ditore me shërbimin e inkasimit,
- përpilimi i raporteve financiare mujore, llogaritja e TVSH-së, plotësimi dhe deklarimi mujor i TVSH-së,
- plotësimi dhe deklarimi i formularëve të tatimit në burim,
- plotësimi dhe deklarimi i formularëve për kontribute,
- raportet tremujore në të ardhurat e kompanis dhe dorëzimi i tyre në ATK,
- përpilimi i pasqyrave financiare në bashkëpunim me ZKF si dhe punët plotësuese me urdhër të Kryeshefit Ekzekutiv,
- Pregaditja e dokumentacionit për Auditim të jashtëm si dhe bashkëpunimi me Auditor të Jashtëm,
- Kryen punë dhe detyra tjera sipas Udhëheqësit.
- Përgaditja superiore – Fakulteti Ekonomik,
- Të jetë Kontabilist i çertifikuar (obligative),
- Së paku 3 vite përvojë pune,
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe Zyrtarët e Lartë tjerë të Kompanisë.

Dokumentat e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letren përcjellëse, biografën tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuar, dëshmin që është Kontabilist i çertifikuar, referencat dhe çertifikatat- të lindjes, shëndetësore, të mos jetë nën hetime dhe i denuar, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njejtë nuk u kthehet aplikantëve.

Aplikacionet merren dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Drejtorin e KRUM-së, zyra nr. 6.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit në të përditshmen "Epoka e Re".

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në:

Zyra Nr.6

Drejtoria e KRUM.

Rr. Bislim Bajgora pn.

Mitrovicë

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► "Tribuna Media Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. të regjistrimit: 71110257 dhe numër fiskal: 601183403.

► Ardian Halili shpall të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit Ekonomik në UP me nr. 40501110010

► Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehe qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumessedetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi